REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. 250/6 Prot. Tiranë, më 13/4/2021

Lënda: Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit "Për zbatimin e Rekomandimeve të lëna në auditimet për 6 mujorin e parë të vitit 2020."

Drejtuar: **Z. Agron HASANAJ**
DREJTORIA RAJONALE TATIMORE

SHKODËR

Nga auditimi i ushtruar në subjektin Drejtoria Rajonale Tatimore, Shkodër në bazë të Programit të Auditimit nr.250, datë 11.02.2021, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, u konstatuan disa mangësi dhe shkelje në drejtim të përmbushjes së zbatimit të rekomandimeve të lena nga auditimi i mëparshëm i ushtruar pranë institucionit tuaj të cilat më hollësisht janë trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bashkëlidhur kësaj shkrese.
Bazuar në nenet 6, 15, 25 dhe 30 të Ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", **si dhe Vendimin nr.48, datë 15.04.2021, të Kryetarit të KLSH-së**, për përmirësimin e gjendjes, ju rekomandojmë zbatimin e masave të mëposhtme:

B. MASA ORGANIZATIVE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Sektorit të Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave rezultoi se ky sektor megjithëse ka një sërë detyrash funksionale për periudhën objekt auditimi ka rezultuar me mungesa në organikë *(e konkretisht të përgjegjësit të sektorit dhe të një specialisti)* pra ka funksionuar pa drejtues dhe të një specialisti, pra dy mungesa në organikë, nga 4 sipas organikës së miratuar gjë që ka ndikuar në përmbushjen të detyrave funksionale në kohë dhe në respektim të dispozitave ligjore. Nga auditimi i punës së këtij sektori u evidentuan mangësi në lidhje me ndjekjen e detyrimeve në rrugë administrative në drejtim të bashkive debitorë referuar mungesë së shkresave drejtuar bashkive debitorë në kohën e krijimit. Mos arkëtimi në kohë i detyrimeve tatimore ndikon edhe në raportimet e kryera në DPT për realizimin e të ardhurave mujore, tre mujore dhe vjetore dhe si rrjedhojë në të ardhurat vjetore të realizuara nga taksa dhe tatime të derdhura në buxhetin e shtetit, veprime që bien ndesh me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 35-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI MBI AUDITIMIN TEMATIK ME OBJEKT: "PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË 6 MUJORIN E PARË TË VITIT 2020" DREJTORIA RAJONALE E TATIMEVE SHKODËR

Nr.	PËRMBAJTJA	FAQJA
I.	**Përmbledhje**	1-7
	I/1. Hyrje	4-5
	I/2. Objektivat e auditimit	5-5
	I/3. Qëllimi i auditimit	5-5
	I/4. Metodologjia auditimit	5-6
	I/5. Konkulzione	6-7
II.	**Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm**	**7-33**

I. PËRMBLEDHJE.

Auditimi u realizua në subjektin *Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër* (DRT) në zbatim të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit*", Udhëzimit të Kryetarit të KLSH-së nr.1, datë 04.11.2016, "*Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit"* si dhe të Programit të Auditimit Tematik me nr.250 prot., datë 11.02.2021 të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me objekt: "Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme".

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka realizuar auditimin në *Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Shkodër*, sipas *Programit të Auditimit Nr.55/1 prot., datë 20.01.2020, ndryshuar me nr.55/2 prot., datë 20.02.2020*, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2018-31.12.2019. Në përfundim të këtij misioni auditimi, me qëllim përmirësimin e gjëndjes janë dërguar rekomandime në DRT Shkodër me shkresën e Kryetarit të KLSH-së nr.55/9 prot, datë 13.05.2020, *"Dërgim i Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimet"*.:

Në përputhje me kërkesat e nenit 15, shkronja "j", të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit"*. Nga DRT Shkodër, me shkresën nr. 4340 prot., datë 04.06.2020, drejtuar KLSH-së është përcjellë plani i masave në vijim të zbatimit të rekomandimeve. Një gjë e tillë është bërë **brenda afatit ligjor, prej 20 ditësh** .

Gjithashtu nga DRT Shkodër është përcjellë përgjigja me shkresën Nr.331/1 prot., datë 13.11.2020 "Mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna", brenda 6-muajve nga data e njoftimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit , veprim ky në përputhje me kërkesat e nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".*

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, u mbajt Akt Verifikimi nr.1, nr.887/3 Prot., datë 19.02.2021, për të cilin nuk u paraqitën komente nga subjekti i audituar. Nga ana e KLSH u përgatit projekt raporti i auditimit dhe u dërgua në DRT Shkodër me shkresën nr.250/2 prot., datë 11.03.2021, për të cilën subjekti konfirmoi njohjen me shkresën nr.1446/3 prot., datë 07.04.2021, protokolluar në KLSH me nr.250/3 prot., datë 09.04.2021 duke mos paraqitur komente. Në këto kushte në përfundim të këtij auditimi përgatitet ky Raport Përfundimtar Auditimi. **Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:**

Nga ana e KLSH me shkresën përcjellëse janë lënë *njëzet e nëntë* **(29)** rekomandime gjithsej nga të cilat gjashtë (6) rekomandime janë për masa disiplinore. *Në lidhje me masat disiplinore, janë rekomanduar masa disiplinore të cila janë kompetencë e DPT-së dhe për të cilën KLSH i është drejtuar DPT më shkresën Nr.55/10., datë 13.05.2020 "Dërgim i Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimet", por për të cilën nuk ka një qëndrim zyrtar nga ana e DPTsë.*
Nga njëzet e tre ***(23)*** *rekomandime gjithsej të lëna në DRT Shkodër* të cilat janë edhe kompetencë e këtij institucioni rezulton se: janë lënë ***8*** *masa organizative,* ***3*** *masa shpërblim dëmi,* ***12*** *masa për eliminimin e efekteve negative*.

Nga njëzet e tre ***(23)*** *rekomandime gjithsej* të lëna në subjektin e audituar DRT Shkodër (duke mos llogaritur 6 masa disiplinore të cilat nuk janë kompetencë e DRT Shkodër dhe për

të cilat KLSH është drejtuar organit kompetentë DPD), rezulton se janë pranuar sipas planit të veprimit të dërgua nga DRT Shkodër njëzet e tre **(23)** masa. Nga auditimi rezulton se, nga njëzet e tre **(23)** masat e rekomanduara dhe të pranuara janë zbatuar plotësisht shtatëmbëdhjetë (**17)** prej tyre, ose 74 %. Janë realizuar pjesërisht tre (**3)** masa, ose 13 % dhe ka mbetur pa zbatuar tre (**3)** masa e cila përfaqëson 13 %. Për masat e pa zbatuara rezulton se për 2 prej tyre pavarësisht se janë pranuar në planin e veprimit të DRT Shkodër, përsëri njëra masë është adresuar DPT për kompetencë kurse masa e dytë nuk është pranuar për nxjerrje përgjegjësie.

Sipas llojit të rekomandimeve të lëna statusi i tyre në mënyrë të përmbledhur paraqitet:

A. Masa Organizative:
Janë rekomanduar tetë (8) masa organizative, nga të cilat janë pranuar tetë (8) masa, nga të cilat gjashtë (6) janë zbatuar plotësisht, një (1) rekomandim është i pazbatuar dhe një (1) masë është e adresuar DPT për kompetencë.
B. Masa Shpërblim Dëmi.
Janë rekomanduar tre (3) masa për shpërblim dëmi me vlerë totale prej: **1,444,208** lekë, nga të cilat: janë pranuar dy (2) masa dhe për të cilat rezulton se dy (2) masat janë zbatuar pjesërisht në vlerën 546,747 lekë lekë. Nga DRT Shkodër nuk është pranuar një (1) masë për shpërblim dëmi ku kërkohet nxjerrja e përgjegjësisë në lidhje me të ardhurat e munguara të konstatuara nga KLSH, në vlerën prej: 151,229 lekë, megjithëse sipas planit të veprimit të dërguar nga DRT Shkodër rezulton e pranuar.
C. Masa për Eliminimin e Paligjshmërive në Administrimin e Fondeve Publike dhe Menaxhimin me Ekonomicitet, Eficencë dhe Efektivitet të Fondeve Publike.
Janë rekomanduar gjithsej 12 masa për eliminimin e paligjshmërive në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike, në vlerën totale prej: 35,338,736 lekë, të cilat **konsiderohen si shpenzime në kushtet e paligjshmërisë.** Nga ku rezulton se janë pranuar 12 masa, të cilat rezultojnë se janë zbatuar njëmbëdhjetë (11) masa dhe një (1) masë është realizuar pjesërisht.

D. Masa Disiplinore
Janë rekomanduar masa disiplinore të cila janë kompetencë e DPT-së dhe për të cilën KLSH i është drejtuar DPT me shkresën Nr.55/10 prot., datë 13.05.2020 "Dërgim i Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimet", për të cilën nuk ka një qëndrim zyrtarë nga ana e DPT-së. Megjithatë nga auditimi konstatohet se në lidhje me pikën E.1 "Masa Disiplinore" ku është kërkuar largimi për 4 punonjës, konstatohet se dy nga punonjësit janë *larguar nga DPT-ja, konkretisht z.O.C[redacted] dhe z.F.T[redacted] Në lidhje me pikën E.2 "Për punonjësit e larguar", ku është kërkuar masa disiplinore për punonjësit e larguar nga puna konsiderohet e ezauruar, pasi asnjëri prej tyre nuk është në marrëdhënie punë me DRT Shkodër.*

I/1. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH-së", në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 241, datë 10.02.2021 dhe autorizimet nr. 241/1 - 241/12 prot datë 11.02.2021, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 11.02.2021 deri në datë 26.02.2021, u krye auditimi në DRT Shkodër

Ky auditim u ushtrua nga grupi i auditimit i përbërë nga: Muhamed Kavaja (përgjegjës grupi dhe Redon Xhelilaj anëtar.
Misioni i auditimit u realizua sipas programit të auditimit në subjektin DRTShkodër nga data 15.02.2021 deri më datë 19.02.2021.

***Përshkrimi i çështjes që auditohet*:**

1. Hartimi i programit (*Plan veprimit*) dhe respektimi i afatit prej *20 ditë* për kthim përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 germa (j), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".
Respektimi i afatit ligjor prej *6 muajsh* nga data e marrjes së njoftim raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, përcaktuar në pikën 2 të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".
2. Zbatimi i rekomandimeve për ndryshime apo përmirësime në legjislacion në fuqi, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuara nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë, të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.
3. Zbatimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuara nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë, të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.
4. Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik, nga nxjerrja e akteve administrative, regjistrimi në kontabilitet, deri në arkëtimin e vlerës, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.
5. Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomicitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve.
6. Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative, nga nisja e procedurave për dhënien e masave, komunikimi zyrtar me personat përkatës dhe vendosjen në dosjen personale, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

I/2. Objekti auditimit: Bazuar në rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ky auditim ka si objektiv, verifikimin në subjekt (*terren*) zbatimin konkret të rekomandimeve të KLSH, pasqyrimin e rasteve të shmangies nga këto rekomandime *(sidomos ato me impakt negativ financiar në buxhet)* dhe vlerëson aspektet e vendimmarrjes së Titullarëve të Institucioneve Publike, në drejtim të rritjes së performancës, me synim përmirësimin e metodës së punës, marrjen e masave të nevojshme strukturore, disiplinore apo ligjore shoqëruar me dëmshpërblimin e dëmit ekonomik të shkaktuar buxhetit të shtetit, nga nëpunësit publikë përgjegjës të subjekteve të audituara.

I/3. Qëllimi auditimit: Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

I/4. Metodologjia e auditimit: Nëpërmjet dërgimit të rekomandimeve në subjektet e audituara, KLSH realizon funksionin kështillues, duke respektuar pavarësinë institucionale, në përputhje me kërkesat e ISSAI 1, Deklarata e Limës "Udhëzime mbi rregullat e auditimit", ISSAI 10, Parimi 7,

Deklarata e Meksikos, "Ekzistencën e Mekanizmave efektive ndjekës në rekomandimet e SAI-ve", si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), për të rritur përgjegjshmërinë e nëpunësve publikë, në pranimin e përgjegjësive dhe ndërmarrjen e masave k.... gjuese dhe përmirësuar punën për të ardhmen i devijimeve nga standardet e pranuara dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së parimeve të, ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, përputhshmëria me kriteret e përcaktuara nga ligjet që rregullojnë funksionimin e njësive të pushtetit vendor, të menaxhimit financiar me qëllim përmirësimin e funksionimit të njësisë në të ardhmen.

Zbatimi i rekomandimeve të lëna në përfundim të auditimit të ushtruar e të dërguara në DRT Shkodër me shkresën përcjellëse Nr.55/9 prot, datë 13.05.2020, *"Dërgim i Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimet".*
Auditimi ushtrohet sipas drejtimeve të programit të auditimit, Nr.250 prot., datë 11.02.2021 të miratuara nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me objekt: "Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme".
Auditimi u ushtrua në përputhje me kriteret dhe kërkesat e përcaktuara nga:
-Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" dhe udhëzimi i Kryetarit të KLSH nr. 1, datë 04.11.2016 "Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit" si dhe standartet e auditimit në fuqi.

I/5. Konkluzioni: Nga përfundimi i punës në terren dhe pas shqyrtimit të dokumentacioneve të subjektit në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja, rezulton se: për rekomandimet e pranuara niveli i zbatimit te tyre plotësisht ose pjesërisht, është në vlerën 87%.

- *Masa Organizative:*

Janë rekomanduar tetë (8) masa organizative, nga të cilat janë pranuar tetë (8) masa, nga të cilat gjashtë (6) janë zbatuar plotësisht, një (1) rekomandim është i pazbatuar dhe një (1) masë është e adresuar DPT për kompetencë.

- *Masa Shpërblim Dëmi:*

Janë rekomanduar tre (3) masa për shpërblim dëmi me vlerë totale prej: 1,444,208 lekë, nga të cilat: janë pranuar dy (2) masa dhe për të cilat rezulton se dy (2) masat janë zbatuar pjesërisht në vlerën 546,747 lekë lekë. Nga DRT Shkodër nuk është pranuar një (1) masë për shpërblim dëmi ku kërkohet nxjerrja e përgjegjësisë në lidhje me të ardhurat e munguara të konstatuara nga KLSH, në vlerën prej: 151,229 lekë, megjithëse sipas planit të veprimit të dërguar nga DRT Shkodër rezulton e pranuar.

- *Masa për Eliminimin e Paligjshmërive në Administrimin e Fondeve Publike dhe Menaxhimin me Ekonomicitet, Eficencë dhe Efektivitet të Fondeve Publike.*

Janë rekomanduar gjithsej 12 masa për eliminimin e paligjshmërive në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike, në vlerën totale prej: 35,338,736 lekë, të cilat konsiderohen si shpenzime në kushtet e paligjshmërisë. Nga

ku rezulton se janë pranuar 12 masa, të cilat rezultojnë se janë zbatuar njëmbëdhjetë (11) masa dhe një (1) masë është realizuar pjesërisht.

- *Masa Disiplinore*

Janë rekomanduar masa disiplinore të cila janë kompetencë e DPT-së dhe për të cilën KLSH i është drejtuar DPT me shkresën Nr.55/10 prot., datë 13.05.2020 "Dërgim i Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimet", për të cilën nuk ka një qëndrim zyrtarë nga ana e DPT-së. Megjithatë nga auditimi konstatohet se në lidhje me pikën E.1 "Masa Disiplinore" ku është kërkuar largimi për 4 punonjës, konstatohet se dy nga punonjësit janë larguar nga DPT-ja, konkretisht z.O.C[redacted] dhe z.F.T[redacted] Në lidhje me pikën E.2 "Për punonjësit e larguar", ku është kërkuar masa disiplinore për punonjësit e larguar nga puna konsiderohet e ezauruar, pasi asnjëri prej tyre nuk është në marrëdhënie punë me DRT Shkodër

II. **Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm**

- *Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".*

Nga verifikimi rezulton se KLSH, ka dërguar në DRT Shkodër, Raportin Përfundimtar të Auditimit me Rekomandimet, me anë të shkresës përcjellëse nr.55/9 prot, datë 13.05.2020, *"Dërgim i Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimet".* Nga DRT Shkodër, me shkresën nr.4340 prot., datë 04.06.2020, *"Dërgohet plani i masave për raportin përfundimtar të KLSH",* drejtuar KLSH është nisur plani i masave në vijim të zbatimit të rekomandimeve, *brenda afatit ligjor, prej 20 ditësh të vendosur nga KLSH,* veprim ky, në përputhje me kërkesat e nenit 15, shkronja "j", të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit",* ku përcaktohet se: "Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas rastit, në fillim, përgjatë dhe/ose në përfundim të veprimtarisë, duhet: të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës".

- *Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*

Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit, nga DRT Shkodër, për zbatim e rekomandimeve të KLSH, *është kthyer përgjigje me shkresë zyrtare Nr.331/1 prot., datë 13.11.2020, brenda 6-muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna,* veprim ky, në përputhje me kërkesat e nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit",* ku përcaktohet se: *"Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të*

rekomandimeve të dhëna".

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, u mbajtë Akt Verifikimi nr.1, nr.887/3 Prot., datë 19.02.2021, për të cilën nuk u paraqiten observime nga subjekti i audituar. Nga ana e KLSH u përgatit projekt raporti i auditimit dhe u dërgua në DRT Shkodër me shkresën nr.250/2 prot., datë 11.03.2021, për të cilën subjekti konfirmojë njohjen me shkresën nr.1446/3 prot., datë 07.04.2021, protokolluar në KLSH me nr.250/3 prot., datë 09.04.2021 duke mos paraqitur observacione. Në këto kushte në përfundim të këtij auditimi përgatitet ky Raport Përfundimtar Auditimi. Dhe në mënyrë të detajuar rezultoi si më poshtë:

***-** Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*

A. *"MASA ORGANIZATIVE":*

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Sektorit të Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave rezultoi se ky sektor megjithëse ka një sërë detyrash funksionale për periudhën objekt auditimi ka rezultuar me mungesa në organikë *(e konkretisht të përgjegjësit të sektorit dhe të një specialisti)* pra ka funksionuar pa drejtues dhe të një specialisti, pra dy mungesa në organikë, nga 4 sipas organikës së miratuar gjë që ka ndikuar në përmbushjen të detyrave funksionale në kohë dhe në respektim të dispozitave ligjore. Nga auditimi i punës së këtij sektori u evidentuan mangësi në lidhje me ndjekjen e detyrimeve në rrugë administrative në drejtim të bashkive debitorë referuar mungesë së shkresave drejtuar bashkive debitorë në kohën e krijimit. Mos arkëtimi në kohë i detyrimeve tatimore ndikon edhe në raportimet e kryera në DPT për realizimin e të ardhurave mujore, tre mujore dhe vjetore dhe si rrjedhojë në të ardhurat vjetore të realizuara nga taksa dhe tatime të derdhura në buxhetin e shtetit, veprime që bien ndesh me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 35-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 1: *Titullari i Institucionit të marrë masat që deri në plotësimin e strukturës, të ndajë përgjegjësitë në punonjësit e tjerë me qëllim eliminimin e mangësive të konstatuara.*

***Afati:* Deri në fund të vitit 2020.**

Komenti i Subjektit: *Me shkresen nr.3933 datë 21.05.2020 është njoftuar DPT-ja në lidhje me "Raportin Përfundimtar dhe rekomandimet mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë në DRT Shkodër.*

Qëndrimi i Audituesve: *Sipas planit të veprimit të institucionit të dërguar në KLSH, ky rekomandim rezulton se është i pranuar, por nga verifikimi i grupit të auditimit rezulton se ky rekomandim është i papranuar për efekt kompetence, por nga DRT Shkodër është i adresuar për zgjidhje në DPT si organi kompetentë me shkresen nr.3933 datë 21.05.2020.*

Statusi: Pa zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua gjendje e lartë e detyrimeve debitorëve, detyrime të cilat kryesisht të krijuar nga viti 2008 e në vazhdim, <u>të cila mbahen në DRT Shkodër jashtë sistemit informatik C@T</u> (sistem informatik i të dhënave sipas tatimpaguesve) por që janë të regjistruara në kontabilitetin e DRT Shkodër, referuar të dhënave nga pasqyrat financiare viti 2018 dhe të vitit 2019, e konkretisht të llogarisë 468 "*Debitorë të ndryshëm*", sipas burimeve të krijimit, kështu:

Në pasqyrat financiare viti 2018, llogaria 468 "*Debitorë të ndryshëm*", është në vlerën 19,603,327 lekë, (Aneksi nr.1) detyrime që sipas burimeve të krijimit përbëhen nga:

a. Detyrime të <u>pa arkëtuara ndër vite</u> në shumën prej 11,913,051 lekë nga viti 2005, të mbajtura jashtë sistemit informatik tatimor C@TS, detyrime të përbëra për tatim mbi të ardhurat personale (për 1 subjekt), detyrim mbi tatim fitimin (për 1 subjekt), detyrime për TVSH (për 2 subjekte), detyrime për kontribute të sigurimeve shoqërore (për 145 subjekte).Theksojmë se detyrimet e mësipërme janë detyrime, gjoba dhe penalitete të cilat nuk janë arkëtuar deri tani pasi janë subjekte që rezultojnë pa Nipt, të çregjistruar nga QKR. Gjithashtu theksojmë se për mungesë dokumentacioni në DRT Shkodër për këto subjekte nuk ka bërë të mundur hedhjen e këtyre detyrimeve në sistemin informatik C@TS të DPT.

b. Detyrime në shumën prej 5,026 lekë (1% i pa derdhur), në favor të DRT Shkodër, si agjent tatimor e cila përfaqëson grande nga transferime të pa arkëtuara për detyrime nga institucione si Bashkia Shkodër dhe Fushë Arrës për 1% e në lidhje me arkëtimin pagesën e tatimi i thjeshtuar mbi biznesin e vogël.

c. Detyrimi në shumën prej 7,685,250 lekë për pulla takse pranë të tretëve (gjendje në fund të vitit e papërdorur në gjykata, prokuroria, bashki të Qarkut të Shkodrës (zyra e gjendjes civile), në zbatim të kërkesave të ligjit nr.9975, datë 28.02.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.26, datë 04.09.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, të cilat përfitojnë si agjentë tatimorë, komisione në masën prej 5% (zyra e gjendjes civile) dhe gjyqësorit (nga pulla takse) në masën 5% dhe 10% që duhet të derdhin detyrimin ndaj DRT në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Drejtësisë nr.33, datë 29.12.2014 " Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e ministrisë së drejtësisë", "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor shtetëror", prokurorisë dhe noterisë, pasi përfitojnë 10% komisione nga shërbimi që kryhet në gjykatë, prokurori. Detyrimi në vlerë në fund të vitit 2018 është në vlerë 7,685,250 lekë dhe i përket viteve 2017-2018 për 10 subjekte, detyrim i cili është me shpresë arkëtimi pasi arkëtohet në vijimësi nga përdorimi i pullave gjatë vitit 2019.

Në fund të vitit 2019, detyrimeve debitorëve janë në shumën prej *<u>18,167,500 lekë (Aneksi 1/1), referuar të dhënave të llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" sipas pasqyrave financiare viti 2019 në DRT, e krahasuar me gjendjen në fund të vitit 2018 ka pësuar rënie në shumën prej 1,435,827 lekë ose 7,3% dhe që ka ardhur si pasojë</u>*

a. Shtesës së detyrimeve në shumën prej 26,599 lekë, të krijuara nga viti 2017-2019, të cilat janë grande nga transferime të pa arkëtuara për detyrime për 1% e TFTH mbi biznesin e vogël dhe që i përkasin 282 subjekte që i përkasin 5 bashkive (Bashkitë Shkodër, Koplik, Fushë Arrëz, Pukë dhe Vau Dejës). Të ardhurat nga tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël të arkëtuara nga DRT, i përket Bashkisë Shkodër në shumën prej 12,965 lekë, Bashkisë Koplik në shumën prej 5,384 lekë, Bashkisë Fushë Arrëz në shumën prej 1,264 lekë, Bashkisë Pukë në shumën prej 552 lekë, Bashkisë Vau Dejës në shumën prej 6,434 lekë. Ky detyrim është e ardhur për DRT Shkodër në cilësinë e agjentit tatimor në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9975, datë 28.02.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.32, datë 31.12.2013 "Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël", e pa arkëtuar deri më 31.12.2019.

b. Uljes së detyrimit për pulla takse, në shumën 6,227,850 për vitin 2017-2019 për 12 subjekte tatimpagues, e cila përfaqëson detyrimin e pa derdhur për furnizim pulle nga institucionet të drejtësisë Qarku Shkodër dhe të zyrave të gjendjes civile pranë bashkive për përdorimin e taksës së pullës nga të tretët për akte administrative dhe certifikata të gjendjes civile. Ky detyrim i përket pullave deklaruar të pa përdorura gjendje në fund të vitit 2019.
Konstatohen mos veprime nga DRT Shkodër nëpërmjet Sektorit të Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave për mbledhjen dhe ndjekjen e detyrimeve, procedura administrative në drejtim të institucioneve përgjegjëse debitorë në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9928 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", i ndryshuar e cila sjell efekte negative në të ardhurat e DRT Shkodër. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 120-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 2.1: *Të merren masa urgjente nga DRT Shkodër në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse në DPT për trajtimin e gjendjes së lartë të debitorëve të cilat mbahen jashtë sistemit informatik ndër vite dhe të detyrimeve të tjera të rezultuara gjendje në pasqyrat financiare në fund të vitit 2019 duke kryer analizat dhe nxjerrë përgjegjësitë individuale për veprimet dhe mosveprimet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.*

Afati: ***Menjëherë dhe në vijimësi***

Komenti i Subjektit: *Sektori i kontabilitetit i ka dërguar se Drejtorisë Kontrollit listën e debitorëve jashtë sistemit C@ts, por Drejtoria e Kontrollit e ka të pamundur hedhjen në sistem për këto detyrime dhe si pasojë mbeten përsëri detyrime jashtë sistemi, pa një kuadër specifik ligjorë.*

Qëndrimi i Audituesve: *Pranuar, por mbetet parealizuar.*

Statusi: *Pa zbatuar.*

Rekomandimi 2.2: *DRT Shkodër nëpërmjet strukturës së përkatëse (Sektorit të Analizës dhe të Kontabilitetit të Ardhurave), të ndërmarrë iniciativa e duhura administrative dhe ligjore në drejtim të arkëtimit të detyrimeve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore si dhe të ndjekë arkëtimin e detyrimit (për taksë pulle e pa përdorur në fund të vitit 2018 dhe 2019) në shumën 6,161,250 lekë, që përfaqëson të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.*

Afati: ***Deri në muajin k.... k të vitit 2020***

Komenti i Subjektit: *Ju bëjmë me dije se shuma 6.161.250 lekë e detyrimeve nga njesitë e vetëqeverisjes vendore është likujduar. Kemi kryer gjithe rakordimet me Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme. Bazuar në rakordimet bëra mes palëve rezulton që pullat gjendje datë 31.12.2019 janë deklaruar të shpenzuara gjatë vitit 2020 dhe janë paguar detyrimet përkatëse.*
Qëndrimi i Audituesve:*. Bazuar në akt-rakordimet përkatëse:*
Akt Rakordimi Bashkia Pukë nr.578/5 prot., datë 29.01.2021.
Akt Rakordimi Bashkia Fushë Arrëz nr.578/9 prot., datë 29.01.2021.
Akt Rakordimi Prokuroria e Rrethit Shkodër nr.578/3 prot., datë 29.01.2021.
Akt Rakordimi Gjykata Apelit Shkodër nr.578 prot., datë 29.01.2021.
Akt Rakordimi Bashkia Malësi e Madhe nr.578/6 prot., datë 29.01.2021.
Akt Rakordimi Bashkia Vau Dejës nr.578/8 prot., datë 29.01.2021.
Akt Rakordimi Prefektura Shkodër nr.578/4 prot., datë 29.01.2021.

Akt Rakordimi Bashkia Shkodër nr.578/7 prot., datë 29.01.2021.
Akt Rakordimi Gjykata e Rrethit Shkodër nr.578/2 prot., datë 29.01.2021.
Akt Rakordimi Gjykata Administrative Shkodër nr.578/1 prot., datë 29.01.2021.

Statusi: *Realizuar.*

3. Gjetje nga auditimi: Në DRT Shkodër u konstatua mos lëvrim të mallrave të konfiskuara nga Drejtoria e Hetimit Tatimor në DRT Shkodër nga viti 2012 në Drejtorinë e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit (DPRMSh), sipas dispozitave ligjore. Nga auditimi rezultoi se në DRT Shkodër gjenden mallra të konfiskuara nga viti 2012, dhe të bëra hyrje pa fletë analize në magazinë më 31.12.2019 në vlerë prej 282,737,52 lekë të përbëra nga ar në sasi 93.4 gram, argjend në sasi prej 303 gram dhe serm në sasi prej 497 gram. Këto mallra të konfiskuara nga viti 2012 nuk janë kaluar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9900, datë 10.04.2008 "Për rezervat materiale të shtetit", neni 2/pika 16, pasi në DRT Shkodër nuk janë kryer në kohë këtyre mallrave analizave duke dokumentuar nëpërmjet hartimit të fletë analizës dhe demonstruar vërtetësinë që mallrat janë arë, argjend, sermë dhe përqindjen e tyre. Nga DRT Shkodër është kryer një korrespondencë në vitin 2018 por pa zgjidhje ndërmjet DPT dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore e cila ka në misionin e saj kryerjen e analizave kimike dhe fizike të mineraleve. Në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 112/2016, datë 03.11.2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore si UMF nr.7, datë 10.01.2017" Për disa shtesa në UMF nr.24, datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në Rep Shqipërisë", aktualisht nuk parashikohen nga viti 2017 e në vazhdim më sekuestrim të mallrave për veprime apo mosveprime të tatimpaguesve, agjentëve tatimor etj, që bien në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 i ndryshua dhe akteve nënligjore të tij pasi përbëjnë shkelje tatimore administrative dhe kategorizohen në dënime administrative. *(Trajtuar më hollësisht në faqen nr.146-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 3: *DRT Shkodër të mare ë masa për lëvrimin e mallrave të sekuestruara në DPRMSH. Në rast se, gjatë dorëzimit konstatohet se mallrat nuk i përgjigjen cilësimeve të bëra në momentin e konfiskimit, çështja të adresohet në organet kompetente në mënyrë që të nxirren përgjegjësitë administrative dhe ligjore ndaj personave përgjegjës sipas dispozitave ligjore në fuqi.*

Afati: ***Menjëherë***

Komenti i Subjektit: *I gjithe malli i konfiskuar është lëvruar pranë DPRMSH Pukë. Aktualisht ne DRT Shkodër nuk kemi gjendje malli te konfiskuar.*
Bazuar në shkresën Nr.200 prot., datë 14.07.2020 dhe fletë hyrjet dhe fletë dalje përkatëse. Fletë-Hyrje nr.10 datë 08.07.2020, Fletë-Dalje nr.67 datë 08.07.2020, paraqitur nga DRT Shkodër grupit të auditimit.

Qëndrimi i Audituesve: *Pranuar, Realizuar. Bazuar në shkresën Nr.200 prot., datë 14.07.2020 dhe fletë hyrjet dhe fletë dalje përkatëse. Fletë-Hyrje nr.10 datë 08.07.2020, Fletë-Dalje nr.67 datë 08.07.2020, paraqitur nga DRT Shkodër grupit të auditimit.*

Statusi: *Zbatuar.*

4. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi grupi i auditimit ka konstatuar problematika në funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si vijon:

a. Aktet dhe dispozitat që rregullojnë funksionimin e institucionit (rregullorja dhe struktura e miratuar), nuk janë në koherencë midis tyre pasi, ndryshimet strukturore të DRT Shkodër nuk janë reflektuar me ndryshime të rregullores. Gjithashtu struktura aktuale e DRT-së, nuk i përgjigjet mbulimit të të gjitha funksioneve të parashikuara, duke krijuar konflikt interesi dhe mbivendosje detyrash. Psh, Drejtori i Funksioneve Mbështetëse që njëkohësisht është dhe NZ i institucionit ka rezultuar që të jetë pjesë e integruar e procedurave të prokurimit me vlera të vogla, që nga procesi i planifikimit të nevojave, prokurimi, marrja në dorëzim, kryerja e transaksionit financiar, kontabilizimi i shpenzimeve dhe reflektimi i tyre në pasqyrat financiare të institucionit, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e pikës 3 (b), të nenit 22, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar ku shprehimisht citohet: *"Veprimtaritë e kontrollit përmbajnë, minimalisht: b) ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin".*

b. Nga ana e DRT Shkodër nuk janë përgatitur dhe nuk janë dorëzuar brenda afateve ligjore Pyetësorët e Vetëvlerësimit, Deklarata dhe Raporti për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm për vitin 2018 dhe 2019, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e nenit 18, të Ligjit nr.10296, datë 08. 07. 2010, i ndryshuar dhe pikat nr.4 dhe 6, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.28, datë 15.12.2011.

c. Procedurat e buxhetimit nuk kanë ndjekur gjurmën standarde të parashikuar në Udhëzimin nr.7, datë 28.02.2018 "Për procedurat standard të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm. Nuk kanë gjetur zbatim detyrimet e nenit 12**,** të Ligjit nr.10296/2010, i ndryshuar, mbi përgjegjësitë menaxheriale të nëpunësit zbatues për garantimin e gjurmës së auditimit**.**

d. NA, NZ dhe drejtuesit e tjerë të strukturave të DRT-së Shkodër nuk zotërojnë informacion të mjaftueshëm për qëllimin dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe kontrollin. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 198-209 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 4: *Titullari i Institucionit, të marrë masa për njohjen dhe implementimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, duke synuar vendosjen e procedurave dhe rregullave të qarta për parandalimin e fenomeneve negative, verifikimeve, autorizimeve, ndarjen e detyrave sipas funksioneve dhe roleve të çdo nëpunësi, zhvillimin e dedikuar profesional të punonjësve me qëllim efektivitetin e sistemeve te kontrollit.*

Afati: ***Menjëherë dhe në vijimësi***

Komenti i Subjektit: *Strukturat e DRT Shkodër funksionion sipas manualeve dhe rregulloreve të miratuar nga DPT Tiranë dhe raporton ne mënyrë periodike pranë institucionit në zbatim dhe implementim të gjithë legjislacionit në fuqi.*

Qëndrimi i Audituesve: *Pranuar, konsiderohet e realizuar dhe detyrim ligjorë i punës së DRT Shkodër në vijimësi.*

Statusi: *Zbatuar.*

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan parregullsi në procedurat e inventarizimit të pasurisë për vitet 2018 dhe 2019**.** *Më konkretisht:*

a. Komisionet e inventarizimit në të dy vitet, para fillimit të inventarizimit nuk kanë mbajtur procesverbal me përgjegjësin material, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e pikës 83

të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" i ndryshuar.

b. Në përfundim të procesit të inventarizimit, komisioni i inventarizimit në vitin 2018, ka identifikuar si të papërdorshëm nga inventari ekonomik 4 artikuj në vlerë fillestare 6,737,839 lekë dhe në vitin 2019 ka identifikuar si të papërdorshëm nga inventari ekonomik 5 artikuj në vlerë fillestare 6,950,839 lekë. Komisioni i inventarizimit, në të dy vitet nuk ka mbajtur procesverbal, por rezultatet i ka pasqyruar vetëm në relacionin përmbledhës, i cili nuk është i miratuar nga titullari i institucionit duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet në pikën 85 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", i ndryshuar.

c. NA nuk ka ngritur komision për vlerësimin e aktiveve, të identifikuara si të papërdorshme nga komisioni i inventarizimit, as në vitin 2018 dhe as në vitin 2019, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e pikave 95 dhe 96 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 148-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 5: *NA dhe NZ të marrin masat, për realizimin dhe monitorimin e procesit të inventarizimit të pasurisë së institucionit në të gjitha fazat si dhe të garantojnë pasqyrimin e saktë të gjendjes së aktiveve të institucionit në pasqyrat financiare vjetore.*

Afati: ***Në vijimësi***

Komenti i Subjektit: *Është mbajtur procesverbal para fillimit të inventarit të magazinës ku janë shënuar numri rendori flet hyrje dhe flet dalje. Është ngritur komision me urdhërin e titullarit nr.22, datë 02.11.2020 për vlerësimin e aktiveve dhe është realizuar inventarizimi.*

Qëndrimi i Audituesve: *Pranuar, Realizuar bazuar në relacionet përkatëse të komisionit. Relacion mbi kryerjen e inventarizimit të pasurisë së institucionit nr.8492/1 prot., datë 15.12.2020, relacioni vlerësimin e aktiveve të propozuara si jashtë funksionit nr.8492/3 prot., datë 31.12.2020.*

Statusi: *Zbatuar.*

6. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me përdorimin e automjeteve në pronësi të DRT dhe dokumentimin e lëvizjes së tyre, nga auditimi u konstatua se DRT Shkodër ka aktualisht në përdorim 11 automjete**,** të cilat nuk mbulohen me drejtues mjeti sipas strukturës së miratuar. Në këto kushte automjetet janë përdorur nga punonjës të ndryshëm të DRT, por në asnjë rast nuk ka autorizim të përdorimit për automjetet të DRT-së ku të përcaktohet drejtuesi i mjetit, targa e mjetit, destinacioni, periudha e lëvizjes, veprime që bien ndesh me përcaktimet e pikës 35, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik",* i ndryshuar. Në fletë udhëtimet e dorëzuara nuk janë evidentuar saktësisht iteneraret që do të përshkruajnë mjetet, si për lëvizjet e brendshme ashtu dhe të jashtme; kilometrat e përshkruara prej lëvizjeve të brendshme arrijnë dy/tre herë më shumë se kilometrat e përshkruara nga lëvizjet e jashtme dhe fletët e udhëtimit rezultojnë të pa nënshkruara nga punonjësit e administratës për lëvizjet e brendshme, veprim që bien ndesh me përcaktimet e pikës 36, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik",* i ndryshuar. Për të njëjtin mjet dhe itinerar sasia e karburantit të konsumuar rezulton e ndryshme në ditë të ndryshme si për lëvizjet e brendshme ashtu dhe të jashtme.

Për periudhën e audituar nuk rezulton asnjë planifikim mbi sasinë e karburantit që do të përdoret nga institucioni për çdo mjet transporti sipas normativave të konsumit. Nuk ka

proces-verbal testimi mjeti për përcaktimin e normës së konsumit të karburantit për 100 km. Institucioni përdor normat e konsumit të vitit 2015 të përcaktuara nga Drejtoria e Administrimit të DPT-së. Nuk ka asnjë urdhër të brendshëm për disiplinimin e shpenzimeve të transportit, për administrimin dhe përdorimin e karburantit. Nuk ka kontrolle të shpenzimeve të fondit për karburant që të verifikojnë nëse fondet publike shpenzohen me ligjshmëri, sipas qëllimit dhe afateve të përcaktuara, në përputhje me detyrimet e marra përsipër, veprime këto që bien ndesh me përcaktimet e neneve 11,12,16 të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 176-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 6.1: *Titullari i Institucionit çdo fillim viti, të ngrejë një komision për testimin e konsumit të karburantit nga mjetet e transportit i cili të dokumentohet në një raport, duke përshkruar në rrugë konkrete normativën e konsumit të karburantit për çdo kategori mjet udhëtimi.*

Afati: ***Menjëherë dhe në vijimësi***

Komenti i Subjektit: *Është nxjerrë urdhri për ngritjen e komisionit dhe është hartur proces verbali i normativave të harxhimit të karburantit. Fletë udhetimet janë përpilohen për çdo rast sipas rekomandive të lëna.*

Qëndrimi i Audituesve: *Pranuar, Realizuar bazuar në Urdhrin Nr.02, datë 04.02.2020 të titullarit si dhe procesverbalit të komisionit.*

Statusi: *Zbatuar.*

Rekomandimi 6.2*: Strukturat drejtuese të cilat janë përgjegjëse për përdorimin e mjeteve të transportit dhe rrjedhimisht edhe të argumentimit të përdorimit të karburantit të hartojnë fletë udhëtimet duke evidentuar destinacionet përfundimtare të udhëtimit në rrethet përkatëse, mbështetur në specifikat e tyre për inspektim (pra destinacione larg qendrave urbane), me synim shmangien e interpretimeve jo të bazuara në dokumente dhe jo korrekte me aktet ligjore në fuqi.*

Afati: ***Menjëherë dhe në vijimësi***

Komenti i Subjektit: *Ky rekomandim është trajtuar me kujdes dhe zbatuar nga ana e institucionit nga viti 2020 e në vazhdimësi.*

Qëndrimi i Audituesve: *Pranuar, Realizuar. Bazuar kjo në fletë udhëtimet e plotësuara sipas rastit dhe të verifikuara nga grupi i auditimit.*

Statusi: ***Zbatuar.***

B. Në lidhje me rekomandimet, "MASA SHPËRBLIM DËMI":

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në 3 (tre) raste punonjësit janë paguar me pagë grupi jo në përputhje me nivelin e diplomës duke shkaktuar dëm në buxhetin e shtetit në total në shumën ***515,244 lekë***, nga të cilat: 203,639 lekë në vitet 2016-2017, 181,573 lekë në vitin 2018, 122,997 lekë në vitin 2019, dhe 8035 lekë në vitin 2020, *Më konkretisht:*

a. Në 2 (dy) raste punonjësit janë paguar me pagë grupi, jo në përputhje me nivelin e diplomës, duke shkaktuar dëm në Buxhetin e Shtetit në shumën totale 190,972 lekë.

-Z. R[redacted], është paguar me pagën e grupit 14,000 lekë, pagë që i korrespondon nivelit të diplomës Master Shkencor dhe jo me pagën e grupit 10,000 lekë që i korrespondon nivelit të diplomës Bachelor që ai zotëron, pra Z. R[redacted] është paguar më tepër në shumën 132,245 lekë. Shuma 132,245 lekë (50,028 lekë në vitin 2017, 54,576 lekë në vitin 2018 dhe 27,641 lekë në vitin 2019) e përfituar nga Z. R[redacted] si diferencë midis pagës së grupit, në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr.187, datë 08.03.2017, lidhja 2, ku përcaktohet vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar, konsiderohet dëm në Buxhetin e Shtetit dhe si e tillë duhet të rikthehet.

-Z. Z[redacted], është paguar me pagën e grupit 14,000 lekë, pagë që i korrespondon nivelit të diplomës Master Shkencor dhe jo me pagën e grupit 10,000 lekë që i korrespondon nivelit të diplomës Bachelor që ai zotëron, pra Z. Z[redacted] është paguar më tepër në shumën 58,727 lekë. Shuma 58,727 lekë (24,608 lekë në vitin 2017 dhe 34,119 lekë në vitin 2018) e përfituar nga Z. Z[redacted] si diferencë midis pagës së grupit në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr.187, datë 08.03.2017, lidhja 2, ku përcaktohet vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar, konsiderohet dëm në buxhetin e shtetit dhe si e tillë duhet të rikthehet.

b. Në 1 (një) rast punonjësi *Z. O*[redacted] *C*[redacted] është paguar me pagë grupi 10,000 lekë, ndërkohë që rezulton i pa pajisur me diplomë duke shkaktuar dëm në Buxhetin e Shtetit në shumën totale 324,272 lekë, për periudhën 02.08.2016-31.01.2020. Shuma 324,272 lekë, (36,866 lekë në vitin 2016, 91,137 lekë në vitin 2017, 92,878 lekë në vitin 2018, 95,356 lekë në vitin 2019 dhe 8,035 lekë në vitin 2020) e përfituar nga Z. C[redacted] në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr.187, datë 08.03.2017, konsiderohet dëm në buxhetin e shtetit dhe si e tillë duhet të rikthehet. *(Trajtuar më hollësisht në faqen62-65;73-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 1.1: *DRT Shkodër të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për të mundësuar arkëtimin në buxhetin e shtetit të shumës 515,244 lekë, përfituar padrejtësisht nga Z. R*[redacted] *në shumën 132,245 lekë; Z. Z*[redacted] *në shumën 58,727 lekë dhe Z. C*[redacted] *në shumën totale 324,272 lekë, në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr.187, datë 08.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës".*

Afati: ***Menjëherë dhe në vijimësi***

Komenti i Subjektit: *Janë njofturë subjektet dhe është kryer likujdimi i shumës nga Z. G*[redacted] *Z*[redacted] *në vlerën 58.727 lekë dhe për Z. O*[redacted] *C*[redacted] *në vlerën 96.948 lekë.*

Qëndrimi i Audituesve: *Ky rekomandim konsiderohet i pranuar. Sipas verifikimit të bërë nga grupi i auditimit rekomandimi rezulton se është realizuar pjesërisht. Tre personat debitorë janë njoftuar nga subjekti dhe nga këto: Z.Z*[redacted] *ka paguar plotësisht, Z.C*[redacted] *ka paguar pjesërisht detyrimin kurse Z.R*[redacted] *nuk ka paguar, vazhdon puna nga subjekti për mbledhjen e detyrimit të mbetur.*

Statusi: *Zbatuar pjesërisht.*

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i shpenzimeve për udhëtime e dieta në vlerën 6,353,100 lekë, u konstatuan parregullsi në respektimin e dispozitave ligjore në shumën **777,735 lekë**, konsideruar dëm në buxhetin e shtetit, m*ë konkretisht:*

a. 27 punonjës në 34 shërbime të kryera janë paguar për shpenzime udhëtimi (fjetje në hotel) mbi bazën e dokumentacionit financiar të parregullt (fatura tatimore për fjetje në hotel të pa

vulosura nga shitësi i shërbimit, të pa nënshkruara nga punonjësi dhe shitësi i shërbimit) duke shkaktuar dëm në buxhetin e shtetit në shumën 654,500 lekë, (prej të cilave 589,000 lekë në vitin 2018 dhe 65,500 lekë në vitin 2019), veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e nenit 4 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar si dhe pikës 36 të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

b. Gjatë vitit 2019, 10 punonjës në 3 shërbime të kryera kanë tejkaluar me nga 1 ditë secili qëndrimin me shërbim jashtë vendit të punës (vërtetuar kjo me faturë tatimore fjetje në hotel një ditë më shumë sesa është urdhëruar në urdhrin e punës). Këto ditë duhet të rezultonin mungesë në listëprezencë dhe listëpagesë por, ndërkohë punonjësit rezultojnë të jenë paguar me ditë të plota pune nga sektori i financës, duke shkaktuar dëm në buxhetin e shtetit, në vitin 2019, në shumën 123,235 lekë. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 84-120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 2: *DRT Shkodër të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për të mundësuar arkëtimin në buxhetin e shtetit të shumës 777,735 lekë, përfituar padrejtësisht nga 29 punonjës të DHT (sipas tabelës nr.26), në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, VKM-së nr.997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.*

Afati: ***Menjëherë***

Komenti i Subjektit: *Janë njoftuar subjektet dhe është kryer likujdimi i shumës 546,747 lekë.*

Qëndrimi i Audituesve: *Pranuar, Realizuar pjesërisht sipas verifikimit të bërë nga grupi i auditimit bazuar në dokumentacionin përkatëse, kanë mbetur pa arkëtuar për 9 persona vlera prej 231,018 lekë.*

Statusi: *Zbatuar pjesërisht.*

3. Gjetje nga auditimi: U konstatuan parregullsi në procedurat për vlerësimin e aktiveve të evidentuara si të papërdorshme nga komisioni i inventarizimit të vitit 2017 dhe të asgjësuara/tjetërsuara në vitin 2018 të cilat kanë sjellë **151,229 lekë të ardhura të munguara**, për buxhetin e institucionit. Më konkretisht:

Komisioni i vlerësimit të aktiveve nuk ka kryer vlerësimin për aktivet e identifikuara si të papërdorshme nga komisioni i inventarizimit, si dhe nuk ka hartuar procesverbal vlerësimi, por ka hartuar vetëm një relacion përmbledhës, në të cilin evidentohen për nxjerrje jashtë përdorimit: Inventar ekonomik nga llog.218 për 90 artikuj në vlerë fillestare 13,572,907 lekë, amortizimi i akumuluar 13,227,188 lekë dhe vlerë të mbetur 345,719 lekë dhe Instalime teknike, makineri e pajisje" nga llog.214 gjithsej 4 artikuj në vlerë fillestare 739,060 lekë, amortizimi i akumuluar 661,533 lekë dhe vlerë të mbetur 77,527 lekë, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e pikave 95,104 dhe 105 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*", i ndryshuar.

Komisioni i asgjësimit/tjetërsimit të aktiveve i kryesuar nga përfaqësues të DPT-së, nga 94 artikuj të evidentuar për nxjerrje jashtë përdorimit ka asgjësuar vetëm 40 artikuj me vlerë fillestare 1,398,903 lekë dhe vlerë të mbetur 272,017 lekë dhe nuk ka kryer asgjësimin e 54

artikujve me vlerë fillestare 12,913,064 lekë dhe vlerë të mbetur 151,229 lekë, që janë objekt i VKM-së nr. 957 datë 19.12.2018 "*Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike*", por në relacion shprehet se procedurat e mëtejshme sipas legjislacionit do të ndiqen nga Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse.

Për 54 artikujt të cilët komisioni nuk i asgjësoi, Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse nuk ka zhvilluar procedurë ankandi, por ia ka dhënë për riciklim Shoqërisë "I.B. R[redacted]" sh.p.k Katund i Ri Durrës, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 109 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"*, i ndryshuar. Moskryerja e procedurave të ankandit në vlerën e mbetur 151,229 lekë përbën të ardhur të munguar, të pa arkëtueshme për buxhetin e institucionit.

Zyra e Financës ka kryer veprimin kontabël duke pakësuar aktivin e pasqyrave financiare në vlerë totale për 14,311,967 lekë përkatësisht llogarinë 218 "Inventar ekonomik" me vlerë fillestare 13,572,907 lekë dhe llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri e pajisje" gjithsej me vlerë fillestare 739,060 lekë referuar vetëm fletë daljes së magazinës, pa bërë kontrollin dhe verifikimin e dokumentacionit autorizues dhe vërtetues, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e pikave 35 dhe 36 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 148-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 3.1: *Titullari i Institucionit të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin e procedurës së ankandit për aktivet të vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimit, moszbatimi i së cilës ka sjellë të ardhura të munguara, të paarkëtueshme për buxhetin e institucionit të vitit 2018, në shumën 151,229 lekë.*

Afati: ***Menjëherë***

Komenti i Subjektit: *Informacioni bërë ish-Drejtorit Rajonal nga ana e Drejtorisë së Funksioneve Mbështetëse si dhe shkresa memo e Drejtorit Rajonal nr.5694/1 datë 22.07.2020, me të cilën nuk pranon se ka vend për nxjerrje përgjegjësi.*

Qëndrimi i Audituesve: *Sipas planit të veprimit të institucionit të dërguar në KLSH, ky rekomandim rezulton se është i pranuar, por nga verifikimi i grupit të auditimit rezulton se ky rekomandim është i papranuar dhe parealizuar.*

Statusi: *Pa zbatuar.*

C. Në lidhje me rekomandimet, "MASA PËR ELIMINIMIN E PALIGJSHMËRIVE NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE":

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan strukturë e paplotësuar e DRT Shkodër në masën 28% ose 36 vende të lira pune në fund të vitit 2018 dhe 15% ose 19 vende të lira pune në fund të vitit 2019. Ndërkohë konstatuam parregullsi në 12 procedura rekrutimit, që përfshin të gjitha nivelet menaxheriale duke shkaktuar shpenzim në kushtet e paligjshmërisë në total në shumën **12,244,690 lekë,** nga të cilat 2,795,401 lekë për vitet 2016-2017; 5,059,718 lekë për vitin 2018, 4,331,398 lekë për vitin 2019 dhe 58,173 lekë në vitin 2020.

Në 1 (një) rast procedura e emërimit të nivelit të lartë menaxherial nga Ministri i Financave, për ***Z. S***[redacted] (i cili zotëron diplomë të nivelit Bachelor), në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Hetimit Tatimor në DRTRV, ka rezultuar, në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr.187, datë 08.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e

ministrive të linjës....." lidhja 6/8, ku si kriter minimal i diplomës së shkollës së lartë, për efekt pranimi në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë në DRT, është 1, që do të thotë kandidati duhet të zotërojë diplomë të nivelit të dytë dhe paga e paguar për të, për periudhën 05.02.2018-12.11.2018, **në shumën 995,564 lekë konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë.**

Në 3 (tre) raste procedurat e rekrutimit të nivelit të mesëm menaxherial kanë rezultuar me diplomë të nivelit Bachelor, në kundërshtim me përcaktimet VKM-së nr.187, datë 08.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës,...", lidhja 6/8, ku si kriter minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt pranimi në pozicionin e përgjegjësit të sektorit në DRT, është 1 ose 2, që do të thotë kandidati duhet të zotërojë diplomë të nivelit të dytë, ose diplomë master profesional si dhe përcaktimet e rregullores "Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor", miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.65, datë 04.10.2017, ndryshuar me Urdhrin nr.65/1, datë 02.02.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve dhe paga e paguar për punonjësit (S[redacted]; R[redacted]; J[redacted]), nga momenti i emërimit, **në shumën 3,753,681 lekë konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë nga të cilat: 1,904,675 në vitin 2017; 1,440,189 lekë në vitin 2018 dhe 408, 817 lekë në vitin 2019**.

Në 1 (një) rast procedura e rekrutimit të nivelit të ulët menaxherial ka rezultuar **pa diplomë**, në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr.187, datë 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës,..." dhe e gjithë pagesa e bërë për periudhën 02.08.2016- 31.01.2020, **në shumën 2,336,875 lekë konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë pasi punonjësi është emëruar në detyrë i padiplomuar, nga të cilat:** 224,108 lekë paguar në vitin 2016;666,618 lekë paguar në vitin 2017; 690,964 lekë paguar në vitin 2018; 697,012 lekë paguar në vitin 2019 dhe 58,173 lekë paguar në vitin 2020.

Në 2 (dy) raste procedurat e rekrutimit të nivelit të ulët menaxherial kanë rezultuar **jo në përputhje me kriterin e diplomës dhe kriterin e vjetërsisë në punë** përcaktuar në Rregulloren "Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor", miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.65, datë 04.10.2017, ndryshuar me Urdhrin nr.65/1, datë 02.02.2018, pasi Z. S[redacted], në momentin e rekrutimi në punë ka qenë i pajisur me diplomë të nivelit Bachelor, me vjetërsi në punë 6 muaj dhe Z. N[redacted] rezulton i diplomuar në nivelin Bachelor, me 0 vite vjetërsi në punë. Paga e paguar në total për punonjësit (Z. S[redacted]; Z. N[redacted]) **në shumën 1,539,091 lekë konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë, nga të cilat: 287,227 lekë në vitin 2018 dhe 1,251,864 lekë në vitin 2019.**

Në 2 (dy) raste procedurat e rekrutimit të nivelit të ulët menaxherial kanë rezultuar **jo në përputhje me kriterin e diplomës** përcaktuar në rregulloren e sipërcituar. Paga e paguar në total për të dy punonjësit **(**Z. A[redacted]; Z. D[redacted]) **në 510,554 lekë nga të cilat: 142,000 lekë në vitin 2018 dhe 368,554lekë në vitin 2019, konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë.**

Në 3 (tre) raste procedurat e rekrutimit të nivelit të ulët menaxherial kanë rezultuar **jo në përputhje me kriterin e vjetërsisë në punë,** përcaktuar në rregulloren e sipërcituar, pasi Znj. F[redacted] në momentin e rekrutimit rezulton me 10 muaj vjetërsi në punë, Z. T[redacted] me vetëm 4 muaj vjetërsi. Dhe Z. N[redacted] pa vjetërsi. Paga e paguar në total për të tre punonjësit **(**Znj. F[redacted]; Z. T[redacted], Z. N[redacted]) **në shumën 3,108,925 lekë nga të cilat: 1,503,774 lekë në vitin 2018 dhe 1,605,151 lekë në vitin 2019, konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë.***(Trajtuar më hollësisht në faqen 55-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 1.1: *Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse të kalojë në një proces shqyrtimi tërësor, gjithë databazën e të punësuarve të DRT-së, për të vlerësuar saktësinë dhe rregullshmërinë e trajtimit financiar të çdo punonjësi si dhe përllogaritjes së komponentëve që përbëjnë pagën, të tilla si: nivelin e diplomës, shtesa për efekt pozicioni, vjetërsinë në punë etj, me qëllim menaxhimin me eficencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike.*

Afati: ***Menjëherë dhe në vijimësi***

Komenti i Subjektit: *Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse ka verfikuar gjithë dosjet e përsonelit në lidhje me nivelin e diplomës, shtesa për efekt pozicioni, vjetërsinë në punë si dhe dosjet personale të punonjësve me kontratë me kopje të diplomës dhe librezës së punës. Kanë përfunduar vlersimi i punonjësve me kontratë të përkohshme punësuar në vitin 2020.*
Qëndrimi i Audituesve: *Pranuar, Realizuar. Bazuar në verifikimin e dokumentacionit të disponuar nga Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse.*
Statusi: *Zbatuar.*

Rekomandimi 1.2: *Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse të plotësojë dosjet personale të punonjësve me kontratë me kopje të diplomës dhe librezës së punës, për efekt të llogaritjes së elementëve të pagës, pasi për punonjësit me Status të Nëpunësit Civil të dhënat personale janë të administruara në sistemin HRMIS.*

Afati: ***Menjëherë dhe në vijimësi***

Komenti i Subjektit: *Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse ka verfikuar gjithë dosjet e përsonelit në lidhje me nivelin e diplomës, shtesa për efekt pozicioni, vjetërsinë në punë si dhe dosjet personale të punonjësve me kontratë me kopje të diplomës dhe librezës së punës. Kanë përfunduar vlersimi i punonjësve me kontratë të përkohshme punësuar në vitin 2020.*

Qëndrimi i Audituesve: *Pranuar, Realizuar. Bazuar në verifikimin e dokumentacionit të disponuar nga Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse.*

Statusi: *Zbatuar plotësisht.*

Rekomandimi 1.3: *DRT Shkodër në bashkëpunim me DPT të fillojnë procedurat ligjore për largimin nga detyra të Z. O[redacted] C[redacted], i emëruar në detyrë ndonëse rezulton i padiplomuar.*

Afati: ***Menjëherë dhe në vijimësi***

Komenti i Subjektit: *Ka ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe financiare në datë 01.05.2020.*

Statusi: *Zbatuar plotësisht.*

Rekomandimi 1.4: *DRT në bashkëpunim me DPT të kryejnë një analizë të kujdesshme në lidhje me nevojat për kapacitete njerëzore dhe profesionale.*

Afati: ***Menjëherë dhe në vijimësi***

Komenti i Subjektit: *Bashkpunimi është i vazhdueshëm më DPT, për plotësimin e nevojave periodike del VKM përkatëse.*

Statusi: *Zbatuar plotësisht.*

2. Gjetje nga auditimi: Për punonjësit me kontratë të përkohshme janë paguar në total për të dy vitet ***12,733,133 lekë,*** prej të cilave *7,074,945 lekë* në vitin 2018 dhe *5,658,188 lekë* në vitin 2019, pagesë e cila konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë, pasi në procedurat e planifikimit, emërimit, evidentimit dhe matjes së punës së punonjësve me kontratë të përkohshme janë konstatuar parregullsi, si vijon:
Nevojat për staf ndihmës nuk kanë kaluar fazën e planifikimit. Drejtoria Rajonale Tatimore nuk ka argumentuar dhe nuk ka mbështetur me evidencë kërkesën për staf ndihmës, si në numër ashtu edhe në pozicionet e punës ku do të punësohen.
DPT ka kryer emërimet në punë për vitin 2018 bazuar vetëm në lista emërore, njëra prej të cilave është dërguar me email nga DRT ditën e hartimit të Vendimit të Drejtorit të PT për emërimin në punë të 21 punonjësve të shërbimit, për një periudhë 1 mujore, ndërkohë që për vitin 2019 janë emëruar në punë 23 punonjës me kontratë të përkohshme pa pasur asnjë lloj planifikimi dhe evidence mbështetëse. Nuk ka evidentim dhe dokumentim të punës së realizuar nga këta punonjës. (*Trajtuar më hollësisht në faqen 78-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 2: *Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse të marrë masa për planifikim real dhe të mirë studiuar të nevojave për staf ndihmës me qëllim, eliminimin e praktikave të rekrutimit të punonjësve me kontratë të përkohshme pa justifikuar nevojat për këtë kategori, hartimin e kërkesave të argumentuara dhe të mbështetura me evidencë të mjaftueshme; hartimin e përshkrimeve të punës për çdo pozicion pune që do të mbulohet nga punonjësit me kontratë të përkohshme, me qëllim menaxhimin me eficencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike.*

Afati: ***Menjëherë dhe në vijimësi***

Komenti i Subjektit: *Punonjësit me kontratë janë rekrutuar nga kërkësat bërë nga individët bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.712 datë 26.10.2020. Janë hartuar edhe përshkrimet e punës për çdo pozicion pune që do të mbulohet nga punonjësit me kontratë të përkohshme.*

Statusi: *Zbatuar plotësisht.*

3. Gjetje nga auditimi: Parregullsi në respektimin e dispozitave ligjore për shpenzimet për udhëtime e dieta të cilat kanë rezultuar me shpenzim në kushtet e paligjshmërisë në shumën **6,353,100 lekë**, nga të cilat 4,294,600 lekë në vitin 2018 dhe 2,058,500 lekë në vitin 2019. Më konkretisht:
a. Në asnjë rast "Shpenzimet e udhëtimit" (për strukturën e Hetimit Tatimor për Rajonin e Veriut), nuk janë autorizuar nga Drejtori i Përgjithshëm i DPT ose nga Drejtori i DRT Shkodër, kompetencë kjo e deleguar nga Ministri i Financave me Autorizimin nr.7448/1, datë 25.05.2018, për vitin 2018 dhe me Autorizimin nr.6159/1, datë 11.04.2019, për vitin 2019, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e Kreut V, pika 2, germa a), paragrafi (i), të VKM nr.997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", i ndryshuar.
b. Në 130 raste ose në 95% të rasteve, janë kryer shpenzime për udhëtim e dieta, **në kushtet e paligjshmërisë në shumën 6,353,100 lekë** nga të cilat, 4,294,600 lekë në vitin 2018 dhe 2,058,500 lekë në vitin 2019, të pambështetur me dokumentacion vërtetues për kryerjen e detyrës, veprim ky në kundërshtim me: Përcaktimet e Udhëzimit nr.22225, datë 16.07.2015, të ish Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve; Përcaktimet e pikës 5.24

"Dokumentacioni administrativ", të Manualit të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, miratuar me Urdhrin nr.93/1, datë 05.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së.

c. Në 22 raste, ose në 16% të rasteve janë konstatuar parregullsi në hartimin e urdhrave të punës të nxjerrë nga Drejtori i Hetimit Tatimor në DPT. Më konkretisht, në urdhër nuk përcaktohet territori ku do të kryhet shërbimi, por në mënyrë të përgjithshme citohet sipas rastit: në territorin e DHT Rajoni Jugor; Qëndror, Verior, në territorin e Shqipërisë…, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e pikës 5.24 "Dokumentacioni administrativ", të Manualit të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, miratuar me Urdhrin nr.93/1, datë 05.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 84-120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 3.1: *DRT Shkodër të forcojë kontrollin e brendshëm në drejtim të garantimit të gjurmës së auditimit për shpenzimet e udhëtimit, me qëllim eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike.*

Komenti i Subjektit: *Shpenzimet e udhëtimit janë bashkëlidhur dokumentacioni sipas detyrave të lëna. Urdhrat e punës janë konceptuar në zbatim të rekomandimeve të lëna.*

Afati: ***Menjëherë dhe në vijimësi***

Qëndrimi i Audituesve: *Pranuar, Realizuar dhe në vijimësi. Bazuar në verifikimin e grupit të auditimit të dokumentacionit paraqitur nga subjekti.*

Statusi: *Zbatuar plotësisht.*

Rekomandimi 3.2: *DHTRV të përmirësojë punën në drejtim të saktësimit në urdhrat e punës të destinacionit të inspektimit, detyrim ky që rrjedh nga zbatimi i Manualit të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, miratuar me Urdhrin nr.93/1, datë 05.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së. Ky përcaktim ka impakt të drejtpërdrejtë në përllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit dhe normativave të harxhimit të karburantit.*

Afati: ***Menjëherë dhe në vijimësi***

Komenti i Subjektit: *Shpenzimet e udhëtimit janë bashkëlidhur dokumentacioni sipas detyrave të lëna. Urdhrat e punës janë konceptuar në zbatim të rekomandimeve të lëna.*

Qëndrimi i Audituesve: *Pranuar, Realizuar dhe në vijimësi. Bazuar në verifikimin e grupit të auditimit të dokumentacionit paraqitur nga subjekti.*

Statusi: *Zbatuar plotësisht.*

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua përdorimi i karburantit në kushtet jo korrekte të zbatimit të kuadrit ligjor të cilat kanë shkaktuar efekte negative në buxhetin e shtetit.

Sasia e karburantit të përdorur për automjetet në dispozicion të DHT, sipas sistemit të kartave elektronike për vitin 2018 ka rezultuar 10,421.49 litra, nga e cila **5,168.14 litra në shumën 909,593 lekë** është e pajustifikuar me fletë udhëtimi dhe për vitin 2019 ka rezultuar 13,482.34 litra, nga e cila **10,233.34 litra në shumën 1,782,834 lekë** është e pajustifikuar me fletë udhëtimi.

Në lidhje me dokumentimin e harxhimit të karburantit nga mjetet në dispozicion të DHT-së për periudhën objekt auditimi është konstatuar se: për muajt shkurt, prill, maj, qershor, k.... k, gusht, shtator të vitit 2018, nuk janë plotësuar fletë udhëtimet që të vërtetojnë lëvizjen e mjeteve e për rrjedhojë sasinë e karburantit të harxhuar. Fletë e udhëtimit që i përkasin muajve të tjerë në të shumtën e rasteve nuk janë nënshkruar për çdo lëvizje, por me një ose dy nënshkrime të përgjithshme, nga një punonjës si drejtues mjeti. Për vitin 2019 prej DHT-së janë dorëzuar fletë udhëtime vetëm për muajin janar duke justifikuar vetëm sasinë prej 449 litra karburant nga 669 litra që rezulton të jetë tërhequr nga programi i kartave elektronike. Nga rakordimi i sasisë së karburantit të përdorur në programin e kartave elektronike me fletë udhëtimet e dorëzuara për mjetet e transportit në dispozicion të DHT-së konstatohet se për periudhën e audituar sasia totale prej 15,401.48 litra karburant (naftë) në shumën 2,692,427 lekë është e pajustifikuar me fletë udhëtime", veprim ky në kundërshtim me përcaktimet në nenet 9, 11, 12, 16 të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar si dhe pikës 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", konsiderohet efekt financiar negativ në Buxhetin e Shtetit.

DRT ka përdorur dhe dokumentuar për nevoja të institucionit 669.5 litra karburant në vlerën 117,949 lekë nga karta Gold (Gjeneratori), kartë e cila ka destinacion përdorimi vetëm për gjeneratorin. Në asnjë rast gjeneratori nuk rezultoi të jetë vënë në punë. Përdorimi i **669.5 litra karburant (naftë) në vlerën 117,949 lekë**, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 34 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik", i ndryshuar, konsiderohet efekt financiar negativ në Buxhetin e Shtetit. (*Trajtuar më hollësisht në faqen 176-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 4: *Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse të marrë të gjitha masat për garantimin e gjurmës së auditimit për dokumentimin e shpenzimeve të karburantit (për automjetet dhe kartën GOLD) me qëllim përdorimin me eficencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore, moszbatimi i së cilës ka sjellë efekt negativ në buxhetin e shtetit gjithsej në shumën 2,810,376 lekë nga e cila 117,949 lekë nga përdorimi jo sipas destinaconit i kartës GOLD (Gjeneratori) dhe 2,692,427 lekë nga mos justifikimi me fletë udhëtimi nga automjetet në dispozicion të DHT-së.*

Afati: ***Menjëherë dhe në vijimësi***

Komenti i Subjektit: *Karta "GOLD" përdoret vetem sipas kritereve për të cilat është përcaktuar (për gjeneratori). Që nga muaji gusht 2019 e në vijim nuk kemi patur nevojë për përdorimin e kartës GOLD.*

Qëndrimi i Audituesve: *Pranuar, Realizuar pjesërisht vetëm për fletë udhëtimet për automjetet në dispozicion dhe përsa i përketë gjeneratorit karta Gold nuk është përdorur në asnjë rast por njëkohësisht nuk ka ndonjë veprim nga DRT Shkodër për hartimin e gjurmës së auditimit. dhe në vijimësi.*

Statusi: *Zbatuar Pjesërisht.*

5. Gjetje nga auditimi: Parregullsi në respektimin e dispozitave ligjore në realizimin e procedurave të prokurimit publik për punë/mallra/shërbime.

I. *Shkelje të afateve kohore të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik në hartimin dhe dorëzimin e regjistrit të parashikimit të prokurimit publik.*

a. Gjatë vitit 2018 janë konstatuar (10 herë) ndryshime të regjistrit të parashikimit të prokurimeve, ndryshime të cilat në asnjë rast nuk shoqërohen me relacion argumentues, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e nenit 4/4 të VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.

b. Për vitin 2018, DRT Shkodër ka dërguar në DPT me 9 ditë vonesë regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike të vitit 2018, dhe në Degën e Thesarit Shkodër me 28 ditë vonesë. E njëjta situatë paraqitet edhe në vitin 2019 ku DRT rezulton të ketë hartuar dhe dërguar 18 dhe 39 ditë me vonesë regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike të vitit 2019, në DPT dhe në Degën e Thesarit Shkodër, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1 të nenit 4 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.

II. *Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël është konstatuar se: nga 34 procedura prokurimi të realizuara në shumën 1,724,768 lekë, janë realizuar* ***jo në përputhje me përcaktimet e kuadrit ligjor në fushën e prokurimeve publike 30 procedura prokurimi në shumën 1,195,437 lekë*** *të cilat konsiderohen efekt negativ në buxhetin e institucionit, të detajuara si më poshtë:*

Në 11 procedura prokurimi në shumën 589,713 lekë prej të cilave,8 procedura prokurimi në shumën 365,973 lekë janë realizuar në vitin 2018 dhe 3 procedura prokurimi në shumën 223,740 lekë janë realizuar në vitin 2019 janë konstatuar si vijon:

Kërkesat për mallra/punë/shërbime nuk janë hartuar nga degët përkatëse, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1 dhe pikës 3 të nenit 40 të VKM-së nr.914, datë 19.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.

Mungesë e procesverbaleve të testimit të tregut dhe të argumentimit e dokumentimit të përllogaritje së fondit limit, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e nenit 59 të VKM-së nr.914, datë 19.12.2014, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.

Në të gjitha procedurat e prokurimit të zhvilluara nuk është ngritur komisioni marrjes në dorëzim të mallit, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e pikave 42, 43 dhe 54 të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar.

Në dosjen e procedurës së prokurimit nuk gjendet i administruar vetëdeklarimi me shkrim i kandidatit ose ofertuesit, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e nenit 15 të VKM-së nr.914, datë 19.12.2014, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar".*

Në të gjitha procedurat e prokurimit të zhvilluara mungon relacioni përmbledhës sipas kërkesave të nenit 68 të VKM-së nr.914, datë 19.12.2014, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar".*

Njësia e prokurimit (funksionale) nuk ka marrë pjesë në asnjë trajnim në fushën e prokurimeve, në kundërshtim me LPP dhe Manualin e Prokurimit ku përcaktohet se, Njësia e prokurimit duhet të kryejë minimumi 1 trajnim në vit.

Në 2 procedura prokurimi të realizuara në vitin 2018, në shumën 49,990 lekë nuk janë përcaktuar specifikimet teknike, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e pikës 4 të nenit 23 të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe përcaktimet e pikës 5 të Udhëzimit nr.3, datë 8.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar.

Në 12 procedura prokurimi në shumën 370,464 lekë, prej të cilave,7 procedura prokurimi në shumën 178,464 lekë janë realizuar në 2018 dhe 5 procedura prokurimi në shumën 192,000 lekë janë realizuar në vitin 2019, janë konstatuar si vijon:

Nuk ka një mekanizëm kontrolli bazuar në informacionin mbi gjendjen teknike, raportet mbi dëmtimet dhe avaritë e automjeteve.

Nga Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse nuk mbahen kartela për secilin automjet, si dhe nuk ka autorizime për personat që i përdorin ato.
Në asnjë nga rastet e riparimit të automjetit nuk rezulton të jenë depozituar pranë magazinës së institucionit pjesët e dëmtuara (që janë ndërruar) të këtij automjeti veprime këto që bien ndesh me përcaktimet e pikave 4, 5, 6, 7, 10, 12 dhe 23 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar si dhe me përcaktimet e pikave 1, 2, 4, 12 të nenit 35 të Rregullores së Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore.
Në 5 procedura prokurimi në shumën 185,270 lekë, prej të cilave, 2 procedura në shumën 40,000 lekë janë zhvilluar në vitin 2018 dhe 3 procedura në shumën 145,270 lekë janë zhvilluar në vitin 2019, janë konstatuar parregullsi në nënshkrimin e faturës së mallrave/shërbimeve nga personat e pranishëm për defektin e ndodhur të cilët kanë qenë prezent sipas procesverbalit të konstatimit dhe nga anëtarët e komisionit të blerjeve me vlerë të vogël, veprim ky në kundërshtim përcaktimin e pikës 18 të Udhëzimit nr.3, datë 8.01.2018 "*Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*", i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 160-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 5.1: *Titullari i Institucionit të analizojë situatën në lidhje me realizimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, mosrespektimin e afateve kohore të hartimit dhe të dërgimit të regjistrit të parashikimit të prokurimit publik për punë/mallra/shërbime, në DPT dhe në Degën e Thesarit, dhe të nxjerrë përgjegjësitë administrative.*

Afati: ***Menjëherë dhe në vijimësi***

Komenti i Subjektit: *Është dërguar në afat regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike.*

Qëndrimi i Audituesve: *Pranuar, Realizuar. Duke u dërguar regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike brenda afatit për vitin 2021.*

Statusi: *Zbatuar plotësisht.*

Rekomandimi 5.2: *Nëpunësi Autorizues të ngrejë menjëherë komisionin e marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve në zbatim të kërkesave të pikave 42,43,54 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.*

Afati: ***Menjëherë dhe në vijimësi***

Komenti i Subjektit: *Është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim.*

Qëndrimi i Audituesve: *Pranuar, Realizuar. Bazuar në Urdhrat e titullarit Nr3., datë 05.03.2020 dhe Nr.3., datë 18.01.2021.*

Statusi: *Zbatuar plotësisht.*

Rekomandimi 5.3: *NZ të garantojë zbatimin e gjurmës së auditimit për procedurat e prokurimit publik në zbatim të kërkesave të nenit 9, pika 2 dhe nenit 16, pika 2, të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, me qëllim përdorimin me eficencë, efektivitet dhe*

*ekonomicitet të fondeve buxhetore, moszbatimi i së cilës ka sjellë efekt negativ në buxhetin e shtetit gjithsej në shumën **1,195,437 lekë.***

***Afati:* Menjëherë dhe në vijimësi**

Komenti i Subjektit: *Është kryer gjurma e auditit për blerjet me vlerë të vogël.*

Statusi: *Zbatuar plotësisht.*

Rekomandimi 5.4: *Titullari i Institucionit, të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të anëtarëve të Njësisë së Prokurimit, me qëllim përmirësimin e punës së Njësisë së Prokurimit në drejtim të hartimit, dokumentimit dhe zbatimit të procedurave konform rregullave të prokurimit publik.*

***Afati:* Menjëherë dhe në vijimësi**

Komenti i Subjektit: *Punonjësitë janë trajnuar online sipas datës dhe orës nga Agjensia e Prokurimeve Publike. Trajminet janë realizuardhe zhvilluar online nga APP.*

Statusi: *Zbatuar plotësisht*

E. *Në lidhje me rekomandimet, "MASA DISIPLINORE":*

Nisur nga problematikat e konstatuara gjatë këtij auditimi, i është kërkuar Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, analizimi i problematikave dhe përgjegjësive individuale për marrjen e masave disiplinore për personat e mëposhtëm dhe jo vetëm, në përputhje me kuadrin rregullative institucional:

Qëndrimi i Audituesve: *Shkresa Nr.55/10., datë 13.05.2020 "Dërgim i Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimet" është adresuar nga KLSH për DPT.*

E.1. *Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës.*

Mbështetur në nenet 141, 153 dhe 154 të Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore: ***"Zgjidhja e menjëhershme e kontratës" neni 153, pika1***, Për *Z. O[redacted] C[redacted]* me detyrë (*Inspektor Zbatimi në DHTRV*). Për mos përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i VKM nr.187, datë 08.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit lidhja 6/8 struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e sistemit të tatimeve, ku si kriter minimal i diplomës së shkollës së lartë, për efekt pranimi në pozicionin e Inspektorit në DRT, është 1, ose 2, ose 3, që do të thotë kandidati mund të punësohet **kur zotëron minimalisht diplomë të nivelit Bachelor**, **duke shkaktuar dëm në Buxhetin e Shtetit,** si dhe Rregullores "Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor", miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.65, datë 04.10.2017, ndryshuar me Urdhrin nr.65/1, datë 02.02.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, ***Z. O[redacted] C[redacted] rezulton pa diplomë universitare.***

Mbështetur në Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës" i ndryshuar, nenet 37, 141, 153 pikat 1 dhe 2 dhe nenin 12 të kontratës individuale të punës, ***i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve,*** analizimin e shkeljeve dhe mangësive të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit për fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore në raport me shkeljet e konstatuara, ndaj nëpunësve përgjegjës:
Për *Z. F[redacted] T[redacted]* me detyrë (Ish Drejtori i Drejtorisë së Hetimit Tatimor Rajoni i Veriut, për periudhën 20.11.2018-11.01.2019; 20.05.2019-17.06.2019 dhe 02.07.2019-07.10.2019);
Për *Z. A[redacted] A[redacted]* me detyrë (Ish Drejtori i Komanduar i Drejtorisë së Hetimit Tatimor Rajoni i Veriut, për periudhën 17.06.2019 - 02.07.2019);
Për *Z. D[redacted] D[redacted]*, me detyrë (Drejtori i Drejtorisë së Hetimit Tatimor Rajoni i Veriut për periudhën 07.10.2019 e në vazhdim).

Komenti i Subjektit: *Dy nga punonjësit janë larguar nga puna, e konkretisht: Z. O.C[redacted] dhe Z.F.T[redacted]. Largimi dhe masa disiplinore janë kompetencë e DPT-së.*

Statusi: *Zbatuar pjesërisht.*

E.2 *Për punonjësit e larguar.*

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimin e tyre.
Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit që konsistojnë në shkelje të rënda mbështetur në nenin 58/ç të *Ligjit nr.153/2013 "Për nëpunësin civil",* masa disiplinore për ***Z. H[redacted] H[redacted]*** me detyrë (*Ish Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, për periudhën 01.01.2018-08.07.2019, në cilësinë e NA)* do të ishte: ***"Largim nga shërbimi civil".*** Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit mbështetur në nenin 153 të Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe nenin 12 të kontratës individuale të punës, masa disiplinore për ***Z. M[redacted] S[redacted]*** *(Ish Drejtori i Drejtorisë së Hetimit Tatimor Rajoni i Veriut, për periudhën 01.01.2018-20.11.2018)* do të ishte ***"Zgjidhja e menjëhershme e kontratës".***

Qëndrimi i Audituesve: *Rekomandim për DPT. Konsiderohet e ezauruar pasi punonjësit janë të larguar nga puna.*

Statusi: *Zbatuar*

- **KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**Nga auditimi tematik mbështetur në standardet e INTOSAI-t dhe manualit për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve së KLSH-së, i kryer në subjektin DRT Shkodër për periudhën 2020 dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, rezultoji se:Nga ana e KLSH me shkresën përcjellëse janë lënë *njëzet e nëntë* **(29)** rekomandime gjithsej nga të cilat gjashtë (6) rekomandime janë për masa disiplinore. *Në lidhje me masat disiplinore, janë rekomanduar masa disiplinore të cila janë kompetencë e DPT-së dhe për të cilën KLSH i është drejtuar DPT më shkresën Nr.55/10., datë 13.05.2020 "Dërgim i Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimet", por për të cilën nuk ka një qëndrim zyrtar nga ana e DPTsë.* Nga njëzet e tre ***(23)*** *rekomandime gjithsej të lëna në DRT Shkodër* të cilat janë edhe kompetencë

e këtij institucioni rezulton se: janë lënë ***8*** *masa organizative*, ***3*** *masa shpërblim dëmi*, ***12*** *masa për eliminimin e efekteve negative*. Nga njëzet e tre ***(23)*** *rekomandime gjithsej* të lëna në subjektin e audituar DRT Shkodër (duke mos llogaritur 6 masa disiplinore të cilat nuk janë kompetencë e DRT Shkodër dhe për të cilat KLSH është drejtuar organit kompetentë DPD), rezulton se janë pranuar sipas planit të veprimit të dërgua nga DRT Shkodër njëzet e tre **(23)** masa. Nga auditimi rezulton se, nga njëzet e tre **(23)** masat e rekomanduara dhe të pranuara janë zbatuar plotësisht shtatëmbëdhjetë (**17)** prej tyre, ose 74 %. Janë realizuar pjesërisht tre (**3)** masa, ose 13 % dhe ka mbetur pa zbatuar tre (**3)** masa e cila përfaqëson 13 %. Për masat e pa zbatuara rezulton se për 2 prej tyre pavarësisht se janë pranuar në planin e veprimit të DRT Shkodër, përsëri njëra masë është adresuar DPT për kompetencë kurse masa e dytë nuk është pranuar për nxjerrje përgjegjësie.

Sipas llojit të rekomandimeve të lëna statusi i tyre në mënyrë të përmbledhur paraqitet:

A. Masa Organizative:
Janë rekomanduar tetë (8) masa organizative, nga të cilat janë pranuar tetë (8) masa, nga të cilat gjashtë (6) janë zbatuar plotësisht, një (1) rekomandim është i pazbatuar dhe një (1) masë është e adresuar DPT për kompetencë.
B. Masa Shpërblim Dëmi.
Janë rekomanduar tre (3) masa për shpërblim dëmi me vlerë totale prej: **1,444,208** lekë, nga të cilat: janë pranuar dy (2) masa dhe për të cilat rezulton se dy (2) masat janë zbatuar pjesërisht në vlerën 546,747 lekë lekë. Nga DRT Shkodër nuk është pranuar një (1) masë për shpërblim dëmi ku kërkohet nxjerrja e përgjegjësisë në lidhje me të ardhurat e munguara të konstatuara nga KLSH, në vlerën prej: 151,229 lekë, megjithëse sipas planit të veprimit të dërguar nga DRT Shkodër rezulton e pranuar.
C. Masa për Eliminimin e Paligjshmërive në Administrimin e Fondeve Publike dhe Menaxhimin me Ekonomicitet, Eficencë dhe Efektivitet të Fondeve Publike.
Janë rekomanduar gjithsej 12 masa për eliminimin e paligjshmërive në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike, në vlerën totale prej: 35,338,736 lekë, të cilat **konsiderohen si shpenzime në kushtet e paligjshmërisë.** Nga ku rezulton se janë pranuar 12 masa, të cilat rezultojnë se janë zbatuar njëmbëdhjetë (11) masa dhe një (1) masë është realizuar pjesërisht.

D. Masa Disiplinore
Janë rekomanduar masa disiplinore të cila janë kompetencë e DPT-së dhe për të cilën KLSH i është drejtuar DPT me shkresën Nr.55/10 prot., datë 13.05.2020 "Dërgim i Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimet", për të cilën nuk ka një qëndrim zyrtarë nga ana e DPT-së. Megjithatë nga auditimi konstatohet se në lidhje me pikën E.1 "Masa Disiplinore" ku është kërkuar largimi për 4 punonjës, konstatohet se dy nga punonjësit janë *larguar nga DPT-ja, konkretisht z.O.C[redacted] dhe z.F.T[redacted]. Në lidhje me pikën E.2 "Për punonjësit e larguar", ku është kërkuar masa disiplinore për punonjësit e larguar nga puna konsiderohet e ezauruar, pasi asnjëri prej tyre nuk është në marrëdhënie punë me DRT Shkodër.*

Përsa më sipër rikërkojmë që Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultuan të, të pazbatuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi, si më poshtë:

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Sektorit të Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave rezultoi se ky sektor megjithëse ka një sërë detyrash funksionale për periudhën objekt auditimi ka rezultuar me mungesa në organikë *(e konkretisht të përgjegjësit të sektorit dhe të një specialisti)* pra ka funksionuar pa drejtues dhe të një specialisti, pra dy mungesa në organikë, nga 4 sipas organikës së miratuar gjë që ka ndikuar në përmbushjen të detyrave funksionale në kohë dhe në respektim të dispozitave ligjore. Nga auditimi i punës së këtij sektori u evidentuan mangësi në lidhje me ndjekjen e detyrimeve në rrugë administrative në drejtim të bashkive debitorë referuar mungesë së shkresave drejtuar bashkive debitorë në kohën e krijimit. Mos arkëtimi në kohë i detyrimeve tatimore ndikon edhe në raportimet e kryera në DPT për realizimin e të ardhurave mujore, tre mujore dhe vjetore dhe si rrjedhojë në të ardhurat vjetore të realizuara nga taksa dhe tatime të derdhura në buxhetin e shtetit, veprime që bien ndesh me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 35-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

<u>Rekomandimi 1:</u> *Titullari i Institucionit të marrë masat që deri në plotësimin e strukturës, të ndajë përgjegjësitë në punonjësit e tjerë me qëllim eliminimin e mangësive të konstatuara.Afati: Deri në fund të vitit 2020.*

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua gjendje e lartë e detyrimeve debitorëve, detyrime të cilat kryesisht të krijuar nga viti 2008 e në vazhdim, <u>të cila mbahen në DRT Shkodër jashtë sistemit informatik C@T</u> (sistem informatik i të dhënave sipas tatimpaguesve) por që janë të regjistruara në kontabilitetin e DRT Shkodër, referuar të dhënave nga pasqyrat financiare viti 2018 dhe të vitit 2019, e konkretisht të llogarisë 468 "*Debitorë të ndryshëm*", sipas burimeve të krijimit, kështu:

Në pasqyrat financiare viti 2018, llogaria 468 "*Debitorë të ndryshëm*", është në vlerën 19,603,327 lekë, (Aneksi nr.1) detyrime që sipas burimeve të krijimit përbëhen nga:

a. Detyrime të <u>pa arkëtuara ndër vite</u> në shumën prej 11,913,051 lekë nga viti 2005, të mbajtura jashtë sistemit informatik tatimor C@TS, detyrime të përbëra për tatim mbi të ardhurat personale (për 1 subjekt), detyrim mbi tatim fitimin (për 1 subjekt), detyrime për TVSH (për 2 subjekte), detyrime për kontribute të sigurimeve shoqërore (për 145 subjekte).Theksojmë se detyrimet e mësipërme janë detyrime, gjoba dhe penalitete të cilat nuk janë arkëtuar deri tani pasi janë subjekte që rezultojnë pa Nipt, të çregjistruar nga QKR. Gjithashtu theksojmë se për mungesë dokumentacioni në DRT Shkodër për këto subjekte nuk ka bërë të mundur hedhjen e këtyre detyrimeve në sistemin informatik C@TS të DPT.

b. Detyrime në shumën prej 5,026 lekë (1% i pa derdhur), në favor të DRT Shkodër, si agjent tatimor e cila përfaqëson grande nga transferime të pa arkëtuara për detyrime nga institucione si Bashkia Shkodër dhe Fushë Arrës për 1% e në lidhje me arkëtimin pagesën e tatimi i thjeshtuar mbi biznesin e vogël.

c. Detyrimi në shumën prej 7,685,250 lekë për pulla takse pranë të tretëve (gjendje në fund të vitit e papërdorur në gjykata, prokuroria, bashki të Qarkut të Shkodrës (zyra e gjendjes civile), në zbatim të kërkesave të ligjit nr.9975, datë 28.02.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.26, datë 04.09.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, të cilat përfitojnë si agjentë tatimorë, komisione në masën prej 5% (zyra e gjendjes civile) dhe gjyqësorit (nga pulla takse) në masën 5% dhe 10% që duhet të

derdhin detyrimin ndaj DRT në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Drejtësisë nr.33, datë 29.12.2014 " Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e ministrisë së drejtësisë", "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor shtetëror", prokurorisë dhe noterisë, pasi përfitojnë 10% komisione nga shërbimi që kryhet në gjykatë, prokurori. Detyrimi në vlerë në fund të vitit 2018 është në vlerë 7,685,250 lekë dhe i përket viteve 2017-2018 për 10 subjekte, detyrim i cili është me shpresë arkëtimi pasi arkëtohet në vijimësi nga përdorimi i pullave gjatë vitit 2019.
Në fund të vitit 2019, detyrimeve debitorëve janë në shumën prej *18,167,500 lekë (Aneksi 1/1), referuar të dhënave të llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" sipas pasqyrave financiare viti 2019 në DRT, e krahasuar me gjendjen në fund të vitit 2018 ka pësuar rënie në shumën prej 1,435,827 lekë ose 7,3% dhe që ka ardhur si pasojë*
a. Shtesës së detyrimeve në shumën prej 26,599 lekë, të krijuara nga viti 2017-2019, të cilat janë grande nga transferime të pa arkëtuara për detyrime për 1% e TFTH mbi biznesin e vogël dhe që i përkasin 282 subjekte që i përkasin 5 bashkive (Bashkitë Shkodër, Koplik, Fushë Arrëz, Pukë dhe Vau Dejës). Të ardhurat nga tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël të arkëtuara nga DRT, i përket Bashkisë Shkodër në shumën prej 12,965 lekë, Bashkisë Koplik në shumën prej 5,384 lekë, Bashkisë Fushë Arrëz në shumën prej 1,264 lekë, Bashkisë Pukë në shumën prej 552 lekë, Bashkisë Vau Dejës në shumën prej 6,434 lekë. Ky detyrim është e ardhur për DRT Shkodër në cilësinë e agjentit tatimor në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9975, datë 28.02.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.32, datë 31.12.2013 "Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël", e pa arkëtuar deri më 31.12.2019.
b. Uljes së detyrimit për pulla takse, në shumën 6,227,850 për vitin 2017-2019 për 12 subjekte tatimpagues, e cila përfaqëson detyrimin e pa derdhur për furnizim pulle nga institucionet të drejtësisë Qarku Shkodër dhe të zyrave të gjendjes civile pranë bashkive për përdorimin e taksës së pullës nga të tretët për akte administrative dhe certifikata të gjendjes civile. Ky detyrim i përket pullave deklaruar të pa përdorura gjendje në fund të vitit 2019.
Konstatohen mos veprime nga DRT Shkodër nëpërmjet Sektorit të Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave për mbledhjen dhe ndjekjen e detyrimeve, procedura administrative në drejtim të institucioneve përgjegjëse debitorë në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9928 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", i ndryshuar e cila sjell efekte negative në të ardhurat e DRT Shkodër. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 120-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 2.1: *Të merren masa urgjente nga DRT Shkodër në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse në DPT për trajtimin e gjendjes së lartë të debitorëve të cilat mbahen jashtë sistemit informatik ndër vite dhe të detyrimeve të tjera të rezultuara gjendje në pasqyrat financiare në fund të vitit 2019 duke kryer analizat dhe nxjerrë përgjegjësitë individuale për veprimet dhe mosveprimet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Afati: Menjëherë dhe në vijimësi.*

C. MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në 3 (tre) raste punonjësit janë paguar me pagë grupi jo në përputhje me nivelin e diplomës duke shkaktuar dëm në buxhetin e shtetit në total në shumën *515,244 lekë*, nga të cilat: 203,639 lekë në vitet 2016-2017, 181,573 lekë në vitin 2018, 122,997 lekë në vitin 2019, dhe 8035 lekë në vitin 2020, *Më konkretisht:*

a. Në 2 (dy) raste punonjësit janë paguar me pagë grupi, jo në përputhje me nivelin e diplomës, duke shkaktuar dëm në Buxhetin e Shtetit në shumën totale 190,972 lekë.

-Z. R[redacted], është paguar me pagën e grupit 14,000 lekë, pagë që i korrespondon nivelit të diplomës Master Shkencor dhe jo me pagën e grupit 10,000 lekë që i korrespondon nivelit të diplomës Bachelor që ai zotëron, pra Z. R[redacted] është paguar më tepër në shumën 132,245 lekë. Shuma 132,245 lekë (50,028 lekë në vitin 2017, 54,576 lekë në vitin 2018 dhe 27,641 lekë në vitin 2019) e përfituar nga Z. R[redacted] si diferencë midis pagës së grupit, në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr.187, datë 08.03.2017, lidhja 2, ku përcaktohet vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar, konsiderohet dëm në Buxhetin e Shtetit dhe si e tillë duhet të rikthehet.

-Z. Z[redacted], është paguar me pagën e grupit 14,000 lekë, pagë që i korrespondon nivelit të diplomës Master Shkencor dhe jo me pagën e grupit 10,000 lekë që i korrespondon nivelit të diplomës Bachelor që ai zotëron, pra Z. Z[redacted] është paguar më tepër në shumën 58,727 lekë. Shuma 58,727 lekë (24,608 lekë në vitin 2017 dhe 34,119 lekë në vitin 2018) e përfituar nga Z. Z[redacted] si diferencë midis pagës së grupit në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr.187, datë 08.03.2017, lidhja 2, ku përcaktohet vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar, konsiderohet dëm në buxhetin e shtetit dhe si e tillë duhet të rikthehet.

b. Në 1 (një) rast punonjësi *Z. O*[redacted] *C*[redacted] është paguar me pagë grupi 10,000 lekë, ndërkohë që rezulton i pa pajisur me diplomë duke shkaktuar dëm në Buxhetin e Shtetit në shumën totale 324,272 lekë, për periudhën 02.08.2016-31.01.2020. Shuma 324,272 lekë, (36,866 lekë në vitin 2016, 91,137 lekë në vitin 2017, 92,878 lekë në vitin 2018, 95,356 lekë në vitin 2019 dhe 8,035 lekë në vitin 2020) e përfituar nga Z. C[redacted] në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr.187, datë 08.03.2017, konsiderohet dëm në buxhetin e shtetit dhe si e tillë duhet të rikthehet. *(Trajtuar më hollësisht në faqen62-65;73-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 1.1: *DRT Shkodër të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për të mundësuar arkëtimin në buxhetin e shtetit të shumës 515,244 lekë, përfituar padrejtësisht nga Z. R*[redacted] *në shumën 132,245 lekë; Z. Z*[redacted] *në shumën 58,727 lekë dhe Z. C*[redacted] *në shumën totale 324,272 lekë, në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr.187, datë 08.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës".Afati: Menjëherë dhe në vijimësi*

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i shpenzimeve për udhëtime e dieta në vlerën 6,353,100 lekë, u konstatuan parregullsi në respektimin e dispozitave ligjore në shumën 777,735 lekë, konsideruar dëm në buxhetin e shtetit, m*ë konkretisht:*

a. 27 punonjës në 34 shërbime të kryera janë paguar për shpenzime udhëtimi (fjetje në hotel) mbi bazën e dokumentacionit financiar të parregullt (fatura tatimore për fjetje në hotel të pa vulosura nga shitësi i shërbimit, të pa nënshkruara nga punonjësi dhe shitësi i shërbimit) duke shkaktuar dëm në buxhetin e shtetit në shumën 654,500 lekë, (prej të cilave 589,000 lekë në vitin 2018 dhe 65,500 lekë në vitin 2019), veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e nenit 4 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar si dhe pikës 36 të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

b. Gjatë vitit 2019, 10 punonjës në 3 shërbime të kryera kanë tejkaluar me nga 1 ditë secili qëndrimin me shërbim jashtë vendit të punës (vërtetuar kjo me faturë tatimore fjetje në hotel një ditë më shumë sesa është urdhëruar në urdhrin e punës). Këto ditë duhet të rezultonin

mungesë në listëprezencë dhe listëpagesë por, ndërkohë punonjësit rezultojnë të jenë paguar me ditë të plota pune nga sektori i financës, duke shkaktuar dëm në buxhetin e shtetit, në vitin 2019, në shumën 123,235 lekë. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 84-120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 2: *DRT Shkodër të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për të mundësuar arkëtimin në buxhetin e shtetit të shumës 777,735 lekë, përfituar padrejtësisht nga 29 punonjës të DHT (sipas tabelës nr.26), në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, VKM-së nr.997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar. Afati: Menjëherë*

3. Gjetje nga auditimi: U konstatuan parregullsi në procedurat për vlerësimin e aktiveve të evidentuara si të papërdorshme nga komisioni i inventarizimit të vitit 2017 dhe të asgjësuara/tjetërsuara në vitin 2018 të cilat kanë sjellë 151,229 lekë të ardhura të munguara, për buxhetin e institucionit. Më konkretisht:

Komisioni i vlerësimit të aktiveve nuk ka kryer vlerësimin për aktivet e identifikuara si të papërdorshme nga komisioni i inventarizimit, si dhe nuk ka hartuar procesverbal vlerësimi, por ka hartuar vetëm një relacion përmbledhës, në të cilin evidentohen për nxjerrje jashtë përdorimit: Inventar ekonomik nga llog.218 për 90 artikuj në vlerë fillestare 13,572,907 lekë, amortizimi i akumuluar 13,227,188 lekë dhe vlerë të mbetur 345,719 lekë dhe Instalime teknike, makineri e pajisje" nga llog.214 gjithsej 4 artikuj në vlerë fillestare 739,060 lekë, amortizimi i akumuluar 661,533 lekë dhe vlerë të mbetur 77,527 lekë, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e pikave 95,104 dhe 105 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*", i ndryshuar.

Komisioni i asgjësimit/tjetërsimit të aktiveve i kryesuar nga përfaqësues të DPT-së, nga 94 artikuj të evidentuar për nxjerrje jashtë përdorimit ka asgjësuar vetëm 40 artikuj me vlerë fillestare 1,398,903 lekë dhe vlerë të mbetur 272,017 lekë dhe nuk ka kryer asgjësimin e 54 artikujve me vlerë fillestare 12,913,064 lekë dhe vlerë të mbetur 151,229 lekë, që janë objekt i VKM-së nr. 957 datë 19.12.2018 "*Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike*", por në relacion shprehet se procedurat e mëtejshme sipas legjislacionit do të ndiqen nga Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse.

Për 54 artikujt të cilët komisioni nuk i asgjësoi, Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse nuk ka zhvilluar procedurë ankandi, por ia ka dhënë për riciklim Shoqërisë "I.B. R[redacted]" sh.p.k Katund i Ri Durrës, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 109 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"*, i ndryshuar. Moskryerja e procedurave të ankandit në vlerën e mbetur 151,229 lekë përbën të ardhur të munguar, të pa arkëtueshme për buxhetin e institucionit.

Zyra e Financës ka kryer veprimin kontabël duke pakësuar aktivin e pasqyrave financiare në vlerë totale për 14,311,967 lekë përkatësisht llogarinë 218 "Inventar ekonomik" me vlerë fillestare 13,572,907 lekë dhe llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri e pajisje" gjithsej me vlerë fillestare 739,060 lekë referuar vetëm fletë daljes së magazinës, pa bërë kontrollin dhe verifikimin e dokumentacionit autorizues dhe vërtetues, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e pikave 35 dhe 36 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 148-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 3.1: *Titullari i Institucionit të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin e procedurës së ankandit për aktivet të vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimit, moszbatimi i së cilës ka sjellë të ardhura të munguara, të paarkëtueshme për buxhetin e institucionit të vitit 2018, në shumën 151,229 lekë. Afati: Menjëherë*

D. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NGA SHPENZIME TË REALIZUARA NË KUSHTE TË PALIGJSHMËRISË NË PROCEDURAT E PROKURIMIT DHE PARREGULLSIVE NË MENAXHIMIN FINANCIAR DHE SISTEMET E KONTROLLIT.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua përdorimi i karburantit në kushtet jo korrekte të zbatimit të kuadrit ligjor të cilat kanë shkaktuar efekte negative në buxhetin e shtetit.

Sasia e karburantit të përdorur për automjetet në dispozicion të DHT, sipas sistemit të kartave elektronike për vitin 2018 ka rezultuar 10,421.49 litra, nga e cila 5,168.14 litra në shumën 909,593 lekë është e pajustifikuar me fletë udhëtimi dhe për vitin 2019 ka rezultuar 13,482.34 litra, nga e cila 10,233.34 litra në shumën 1,782,834 lekë është e pajustifikuar me fletë udhëtimi.

Në lidhje me dokumentimin e harxhimit të karburantit nga mjetet në dispozicion të DHT-së për periudhën objekt auditimi është konstatuar se: për muajt shkurt, prill, maj, qershor, k.... k, gusht, shtator të vitit 2018, nuk janë plotësuar fletë udhëtimet që të vërtetojnë lëvizjen e mjeteve e për rrjedhojë sasinë e karburantit të harxhuar. Fletë e udhëtimit që i përkasin muajve të tjerë në të shumtën e rasteve nuk janë nënshkruar për çdo lëvizje, por me një ose dy nënshkrime të përgjithshme, nga një punonjës si drejtues mjeti. Për vitin 2019 prej DHT-së janë dorëzuar fletë udhëtime vetëm për muajin janar duke justifikuar vetëm sasinë prej 449 litra karburant nga 669 litra që rezulton të jetë tërhequr nga programi i kartave elektronike. Nga rakordimi i sasisë së karburantit të përdorur në programin e kartave elektronike me fletë udhëtimet e dorëzuara për mjetet e transportit në dispozicion të DHT-së konstatohet se për periudhën e audituar sasia totale prej 15,401.48 litra karburant (naftë) në shumën 2,692,427 lekë është e pajustifikuar me fletë udhëtime", veprim ky në kundërshtim me përcaktimet në nenet 9, 11, 12, 16 të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar si dhe pikës 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", konsiderohet efekt financiar negativ në Buxhetin e Shtetit.

DRT ka përdorur dhe dokumentuar për nevoja të institucionit 669.5 litra karburant në vlerën 117,949 lekë nga karta Gold (Gjeneratori), kartë e cila ka destinacion përdorimi vetëm për gjeneratorin. Në asnjë rast gjeneratori nuk rezultoi të jetë vënë në punë. Përdorimi i 669.5 litra karburant (naftë) në vlerën 117,949 lekë, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 34 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik", i ndryshuar, konsiderohet efekt financiar negativ në Buxhetin e Shtetit. (*Trajtuar më hollësisht në faqen 176-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 4: *Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse të marrë të gjitha masat për garantimin e gjurmës së auditimit për dokumentimin e shpenzimeve të karburantit (për automjetet dhe kartën GOLD) me qëllim përdorimin me eficencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore, moszbatimi i së cilës ka sjellë efekt negativ në buxhetin e shtetit gjithsej në shumën 2,810,376 lekë nga e cila 117,949 lekë nga përdorimi jo sipas destinaconit*

i kartës GOLD (Gjeneratori) dhe 2,692,427 lekë nga mos justifikimi me fletë udhëtimi nga automjetet në dispozicion të DHT-së. Afati: Menjëherë dhe në vijimësi.

Sipas tabelës përmbledhëse të masave të rekomanduara gjendja paraqitet si më poshtë:

Nr	Subjekt i Audituar	Rekomandime Gjithsej	Pa pranuar	Pranuar	Shkalla e pranimit në %	Statusi i rekomandimeve të pranuara			
						Pa zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Zbatuar	Në proces zbatimi
1	DRT Shkodër	23	0	23	100%	3	3	17	0

Për sa më sipër për të gjitha rekomandimet që konsiderohen të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi ose të papranuara, inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të tyre brenda 6-mujorit të parë të vitit 2021 dhe në mbështetje të nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",* brenda 6 muajve nga përcjellja e rekomandimeve tona, të raportohet me shkrim pranë KLSH mbi ecurinë e zbatimit të tyre.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT